



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR

2015

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS-KANALIZIME

JANAR, 2016

SHKURTIMET.....	4
FJALA HYRËSE.....	5
1. VEPRIMTARIA VJETORE E ERRU-SË.....	7
1.1. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË.....	8
1.2. FORMA ORGANIZATIVE E ERRU-SË.....	9
1.3. VEPRIMTARIA RREGULLATORE DHE MONITORUESE.....	10
• <i>Licencimi i operatorëve ujësjellës-kanalizime.....</i>	<i>10</i>
• <i>Tarifat dhe procesi tarifar, përballueshmëria e tarifave.....</i>	<i>13</i>
• <i>Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit.....</i>	<i>20</i>
• <i>Përmirësimi i standarteve në sektorin UK nëpërmjet instrumentave rregullatore.....</i>	<i>25</i>
1.4. KONSOLIDIMI INSTITUCIONAL.....	30
• <i>Problematikat në lidhje me kuadrin ligjor të ERRU.....</i>	<i>30</i>
• <i>Bashkëpunimi me aktorët në sektor.....</i>	<i>32</i>
1.5. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET E ERRU-SË.....	34
• <i>Burimet e financimit të ERRU-së.....</i>	<i>34</i>
• <i>Shpenzimet operative.....</i>	<i>35</i>
• <i>Pagesa rregullatore për vitin 2015.....</i>	<i>37</i>
1.6. RREGULLIMI PËR VITIN 2016.....	38
2. GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME.....	39
2.1. ORGANIZIMI I SEKTORIT UK DHE REFORMA TERRITORIALE.....	39
2.2. MBULIMI ME SHËRBIM UK DHE SFIDAT NË LICENCIM.....	41
2.3. KOSTOT PËR SHËRBIMET UJËSJELLËS E KANALIZIME.....	45
2.4. PERFORMANCA E SEKTORIT UK PËR VITIN 2015.....	50
2.5. OBJEKTIVAT RREGULLATORE TË SEKTORIT UK PËR VITIN 2016.....	54
<i>Aneksi 1 – Situata e licencimit të shoqërive UK në vitin 2015.....</i>	<i>57</i>
<i>Aneksi 2 - Aplikimet për ndryshimin për tarifa në vitin 2015.....</i>	<i>58</i>
<i>Aneksi 3 - Tarifat Aktuale për vitin 2015.....</i>	<i>59</i>
<i>Aneksi 4 - Zonat e juridiksionit sipas Reformës territoriale për shoqëritë UK ekzistuese dhe zonat e pambuluara me shërbim nga këto shoqëri.....</i>	<i>61</i>

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjellës Kanalizime
U	Ujësjellës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
SHA	Shoqëri Aksionere
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
DRSH	Drejtoria Rajonale Shëndetësore
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit / Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
IWA	International Water Association / Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
OM	Kosto Operative dhe Mirëmbajtje

Fjala Hyrëse

Raporti Vjetor, bazuar në ligjin nr 8102, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, dt. 28.03.1996, i ndryshuar, është një detyrim ligjor i Entit Rregullator të Ujit, ku përveç aktiviteteve dhe arritjeve të institucionit në përmbushje të mandatit ligjor si dhe parashikimeve për zhvillimet e vitit pasardhës, analizohet dhe paraqitet edhe një situatë aktuale e sektorit ujësjellës - kanalizime në Shqipëri. Në vijim të këtij Raporti Vjetor dhe në plotësim të tij, ERRU publikon dhe Raportin e Performancës së shoqërive UK, ku shqyrtohet në mënyrë të detajuar performanca individuale e shoqërive në veçanti dhe ofrohet një tablo më e plotë dhe objektive e gjendjes së përgjithshme në sektorin Ujësjellës Kanalizime.

Viti 2015 shënoi vendimmarrje të rëndësishme nga ana e politikë - bërësve në lidhje me organizimin e ri territorial, duke organizuar qeverisjen vendore në 61 bashki, të cilat do të çojnë në rritjen e efikasitetit administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Në këtë kuadër parashikohen dhe po përgatiten nga Ministria e linjës ndryshime dhe në organizimin e funksionimit të sektorit UK. ERRU në mbështetje të qeverisjes qendrore në reformat e herëpashershme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, do të bashkëpunojë me të gjithë ekspertizën dhe ekspertizën e tij dhe në vendimmarrjen politike për realizimin e këtyre reformave të suksesshme në sektor.

Pavarësisht ndryshimeve të pritshme në sektor, Enti Rregullator i Ujit është duke vazhduar të kryejë funksionet e tij duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK, në mënyrë që të realizojë misionin e tij, të **sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.**

Edhe për vitin 2015, fokusi kryesor i Entit Rregullator të Ujit ka qenë përmirësimi i kuadrit rregullator, licencimi dhe miratimi i tarifave për shoqëritë UK. Në këtë kuadër, Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar 24 mbledhje komisioni. Gjatë këtyre mbledhjeve janë marrë 45 vendime për licenca, tarifa, përmirësime të instrumenteve rregullatore dhe vendime administrative.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij, është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave, të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove, me qëllim uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundësive për shlyerjen e kredive, e lidhur kjo edhe me përmirësimin e performancës.

Rritja e shkallës së mbulimit të kostove të shërbimeve nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përmirësimi i menaxhimit, duke rritur efikasitetin operacionale në lidhje me faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave si dhe kontrollin e kostove. Faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të paguar për shërbimet e ofruara bëjnë të mundur dhe rritjen e të ardhurave për shoqëritë UK.

Në vitin 2015, **mbulimi i kostove OM me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti në sektor është 104%**. Numri i shoqërive që mbulojnë 100% koston e operimit dhe mirëmbajtjes është 19 (nëntëmbëdhjetë). Ndërsa **mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është 79%**, dhe vetëm 6 (gjashtë) shoqëri kanë arritur të mbulojnë 100% këto kosto.

ERRU do të vazhdojë të stimulojë dhe mbështesë përpjekjet e shoqërive për të përmirësuar shërbimet ndaj klientëve të tyre, por nga ana tjetër kërkon që shoqëritë të marrin në konsideratë të gjitha opsionet për të rritur efikasitetin operacionale.

Nivelet e treguesve kryesorë të performancës tregojnë se në vitin 2015 sektori nuk ka patur ndryshime pozitive të dukshme. Krahasuar me një vit më parë, gjashtë nga këta tregues, mbulimi me ujë, mbulimi me kanalizime, uji pa të ardhura, kohëzgjatja e furnizimit me ujë, efikasiteti i stafit dhe norma e arkëtimit nuk kanë ndryshuar. Niveli i mbulimit të Kostove OM dhe Kostove Totale është më i ulët se një vit më parë, pra tendenca nuk ka qënë pozitive. Treguesi i vetëm që ka shënuar rritje është niveli i matjes.

ERRU nxit të gjitha shoqëritë që të ndjekin shembullin e performuesve më të mirë në këtë drejtim në mënyrë që të sigurojnë në të ardhmen qëndrueshmërinë e tyre financiare. Faturimi sistematik i të gjithë klientëve, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu detyrimi për arkëtim kontribuojnë në arritjen e një norme më të mirë arkëtimi. Një ndikim pozitiv ka gjithashtu ofrimi cilësor i shërbimeve. Shoqëritë të cilat ofrojnë shërbime cilësore nuk hasin vështirësi në mbledhjen e të ardhurave, edhe kur tarifat janë më të larta.

Bazuar në treguesit e performancës së sektorit UK të përzgjedhur nga ERRU, për vitin 2015, në raport janë përcaktuar edhe objektivat e pritshëm për vitin 2016.

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

1. Veprimtaria vjetore e ERRU-së

Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU) është një institucion i pavarur publik që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Bazuar në nenin 31 të këtij ligji, "Mbledhja e raporteve dhe e informacionit", pika 1, ERRU çdo vit duhet t'i paraqesë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, një raport vjetor ku të përshkruhet puna njëvjeçare e Entit, parashikimet për zhvillimet e vitit pasardhës si dhe gjendja e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri.

Në mars të vitit 2015, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi **rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2014"**, duke vlerësuar rolin e tij në sektorin ujësjellës kanalizime.

Direktivat e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- *Të bashkëpunojë me të gjitha institucionet qendrore përgjegjëse në përballimin e sfidave për sigurimin e një ecurie të kënaqshme të këtij sektori;*
- *Të rrisë përpjekjet në forcimin e kapaciteteve të tij administrative dhe pavarësisë operacionale;*
- *Në kuadër të reformës së re administrative territoriale dhe ristrukturimit të sektorit, të mbështesë zonat e reja administrative, në mënyrë që të sigurohet një mbulim total me shërbim ujësjellës-kanalizime i rregulluar, në të gjithë vendin;*
- *Të vijojë përpjekjet në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit dhe zgjidhjes së ankesave të tyre, pavarësisht rolit ndërmjetësues;*
- *Në procesin e miratimit të tarifave, të mbajë parasysh, nga njëra anë, mbrojtjen e interesit të konsumatorëve, dhe nga ana tjetër, rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.*

Në punën e tij gjatë vitit 2015, ERRU përveç realizimit të mandatit të tij rregullator të përcaktuara në ligj, u mbështet edhe në direktivat e përcaktuara në këtë rezolutë.

1.1. Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

Qëllimi kryesor i ligjit 8102 mbi të cilin funksionon ERRU, është vendosja e një kuadri rregullator dhe ngritja e një Enti të pavarur për të garantuar e mbrojtur interesat publike dhe për të krijuar një mjedis transparent ligjor dhe rregullator në sektor.

Vizioni i ERRU është: “Një sektor ujësjellës-kanalizime financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri”.

Misioni i ERRU është: “Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht”.

Autoriteti rregullator i ERRU-së shtrihet në të gjitha veprimtaritë private dhe shtetërore në sektorin ujësjellës e të kanalizimeve.

Detyrat e përgjithshme të ERRU-së janë:

- të nxisë eficientë dhe sigurinë nga ana e të licencuarëve dhe përdorimin me efikasitet të ujit;
- të bëjë të mundur që të licencuarit të financojë veprimtaritë e autorizuara nga licenca që kanë marrë;
- të bëjë të mundur që të plotësohen të gjitha kërkesat e arsyeshme për furnizimin me ujë brenda kufijve të leverdisë ekonomike;
- të garantojë që të licensuarit të veprojnë në përputhje me kushtet e licencës së tyre dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me:
 - çmimet, tarifatat dhe kushtet e tjera të shërbimit;
 - cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- aty ku është e mundur dhe efikase, të nxisë konkurrencën;
- të arrijë transparencën në veprimtaritë e tij;
- të gjejë një ekuilibër të drejtë midis interesave të konsumatorëve, qeverisjes qendrore, publikut, investitorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e furnizimit me ujë;
- të marrë pjesë si këshillues në hartimin e strategjive dhe të politikave kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

1.2. Forma organizative e ERRU-së

ERRU drejtohet nga **Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR)**, i cili ushtron këto kompetenca të përgjithshme:

- Jep licenca për njësitë komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;
- Miraton çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e ndotura dhe tarifatat e trajtimit të tyre;
- Krijon dhe garanton zbatimin e standardeve të punës për të licencuarit;
- Inkurajon standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;
- Përgatit raporte për gjendjen e sektorit për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin si dhe grumbullon informacionin përkatës nga të licencuarit;
- Vendos sanksione administrative dhe monetare;

Struktura dhe organika e ERRU është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendim nr. 94, datë 30.04.2007, i ndryshuar.

Një skemë e kësaj strukture të ERRU është paraqitur më poshtë:





Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të ERRU-së janë 5 Komisionerë, 13 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve është si më poshtë:



Grafiku 1: Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve

1.3. Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese

- **Licencimi i operatorëve ujësjellës-kanalizime**

Në vendin tonë në korrik të vitit 2014 u miratua Reforma administrative-territoriale duke organizuar qeverisjen vendore në 61 bashki të cilat do të çojnë në rritjen e efikasitetit administrativ, profesional dhe teknik të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Gjatë vitit 2015, kjo reformë administrative-territoriale ishte parashikuar të zbatohet edhe në sektorin ujësjellës kanalizime, por ende nuk është miratuar paketa ligjore me aktet e nënaktet përkatëse për t'u paraprirë ndryshimeve që do të ndodhin shoqërive UK. Përveç kësaj pakete ligjore, ende nuk janë bërë inventarizimet e aseteve të të gjitha sistemeve të Ujësjellës Kanalizimeve të njësisve administrative (ish komunat).

Pavarësisht situatës ende të papërcaktuar (ristrukturimit të sektorit UK si pasojë e reformës administrative-territoriale) të sektorit UK, Enti Rregullator i Ujit është duke vazhduar të kryejë funksionet e tij, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK, në mënyrë që bazuar në ligjin nr. 8102, datë 23.03.1996, i ndryshuar dhe Rregulloren e

Licencimit, miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, i ndryshuar, çdo person fizik ose juridik që ushtron aktivitetin e tij në sektorin ujësjellës kanalizime të jetë i licencuar.

Në sektorin ujësjellës kanalizime vazhdojnë të ofrojnë shërbimin e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik 57 shoqëri, nga të cilat shërbimin e përpunimit të ujit për konsum publik e kryejnë 2 prej këtyre shoqërive, largimin e ujërave të ndotura 28 prej tyre dhe përpunimin e ujërave të ndotura vetëm 5 prej tyre.

Gjatë vitit 2015 pranë institucionit tonë, kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence, 23 (njëzetë e tre) shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar 10 (dhjetë) operatorë, ndërsa 13 (trembëdhjetë) aplikime të tjera mbeten ende në proces.

Aplikimet e mësipërme kanë ardhur nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) shoqëri si pasojë e përfundimit të afatit të licencës, prej të cilave 1 (një) edhe si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit, 1 (një) shoqëri si pasojë e përfundimit të afatit të kategorisë D të licencës, 1 (një) shoqëri si pasojë e ndryshimit të drejtuesit teknik dhe 1 (një) shoqëri si pasojë e shtimit të kategorisë C. Ndërsa 7 (shtatë) shoqëri të tjera kanë aplikuar për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

Po gjatë këtij viti, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR, operatorët Sh.A.UK Rrëshen dhe operatori Sh.A.UK Shkodër të cilët kishin nisur aplikimin që në vitin 2014, por që procedura përfundoi ligjërisht vetëm gjatë këtij viti.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2015, duke marrë parasysh dhe problematikat e paraqitura më sipër, për 57 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime është si më poshtë (një informacion më i detajuar gjendet në Aneksin 1.):

- 43 (dyzetë e tre) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- 7 (shtatë) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës;
- 3 (tre) operatorë u ka përfunduar afati dhe nuk kanë aplikuar akoma për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
- 4 (katër) operatorë janë pa licencë.


Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2015, nga ana e shoqërive që operojnë në sektorin UK, u hasën përsëri problematika që janë të njohura për ERRU-në. Ndër to, si më kritike vazhdojnë të mbeten:

- **Vështirësi në regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR** si: sh.a U Rrëshen, sh.a UK Mallakastër, sh.a UK Këlcyrë, UK Fushë Arrëz;

- **Vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme** nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit dhe kryesisht këto vonesa kanë ardhur për pajisjen me lejet e mjedisit (në rastin e kategorisë së përpunimit të ujërave të ndotura) si sh.a UK Durrës, dëshmitë e penaltetit si: sh.a UK Elbasan, por nuk mungojnë rastet kur dokumentacioni vonohet si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë.
- Gjithashtu është vënë re dhe **një ndryshim në masë i drejtuesve ligjorë** të shoqërive UK. Në këtë kuadër do të donim t’ju sugjeronim drejtuesve të pushtetit lokal si pronarë të shoqërive që lëvizja e drejtuesve të bëhet duke u bazuar në treguesit e performancës të arritur nga shoqëria, sidomos atyre të lidhura drejtpërsëdrejti me menaxhimin.

Këto problematika vihen re akoma më tepër në shoqëritë e vogla. Këto shoqëri vazhdojnë të hasin mjaft vështirësi në plotësimin e dokumentacionit për licencim. Bazuar në draft aktet nënligjore për ristrukturimin e sektorit UK në zbatim të reformës administrative, të cilat janë në diskutim, disa prej këtyre shoqërive mendohet që do të bëhen pjesë e zonave të juridiksionit të bashkive të mëdha, duke zvogëluar kështu numrin e problematikave që këto shoqëri kanë hasur vit pas viti.

Gjatë këtij viti, tek operatorët pa licencë u përfshi dhe sh.a ujësjellës kanalizime Vlorë, e cila nuk ka respektuar afatet e procedurave për rinovimin e licencës dhe masa administrative është në proces ekzekutimi.



Grafiku 2. Situata aktuale e licencimit

ERRU ka qenë dhe do vazhdojë të jetë gjithmonë bashkëpunues dhe i gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur shoqëritë në zgjidhjen e problemeve që kanë dhe do të kenë në zbatim të Reformës Administrative Territoriale.

- **Tarifat dhe procesi tarifor, përballueshmëria e tarifave**

Në zbatim të ligjit nr. 8102 datë 28.06.1998 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU është autoriteti që miraton tarifatat e shërbimeve UK si dhe përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave. Në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 28, datë 28.09.2011, ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave”, ku janë përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Vlerësimi i propozimit për ndryshimin e tarifave për secilin aplikim është bërë mbi bazën e analizës së situatës aktuale ekonomike, financiare dhe treguesve kryesore të performancës, tendencës së tyre, synimeve të operatorit me tarifatat e kërkuara si dhe kushteve specifike të operimit, të cilat bëjnë që edhe pritshmëritë nga ndryshimi i tarifave të jenë të ndryshme për çdo shoqëri.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove me të ardhurat nga aktiviteti, duke rritur kështu qëndrueshmërinë financiare të operatorëve (*tarifat aktuale të miratuara nga KKRR deri më tani për operatorët UK janë paraqitur në detaje në Aneksin 3*).

Procedura e miratimit të tarifave fillon me përgatitjen e aplikimit për ndryshimin e tarifave nga operatori, i cili duhet të paraqitet brenda datës 30 Qershor të çdo viti. Procesi i miratimit, i cili kalon në disa hapa, fillon kur aplikimi për ndryshimin e tarifave është plotësuar sipas kërkesave të Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave". Afati i fundit për miratimin e tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator është 30 marsi i vitit pasardhës.

Në vitin 2015 paraqitën kërkesën për ndryshimin e tarifave Sh.a UK Korçë Qytet, Sh.a UK Krujë, Sh.a UK Durrës dhe Sh.a UK Elbasan Qytet.

Procedura ka vazhduar me analizën tekniko- ekonomike të aplikimit për ndryshimin e tarifave për Sh.a UK Durrës dhe Sh.a UK Elbasan. Për Sh.a UK Korçë dhe Sh.a UK Krujë procesi nuk ka vazhduar për mosplotësim të dokumentacionit të aplikimit për ndryshimin e tarifave.

Gjithashtu, Komisioni Kombëtar Rregullator në muajin mars të vitit 2015 përfundoi procedurën e miratimit të tarifave për Sh.a UK Fier, Sh.a UK Gjirokastrë, Sh.a UK Lezhë, Sh.a UK Lushnjë, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Ersekë, Sh.a UK Korçë Qytet, Sh.a U Korçë Fshat, Sh.a UK Krujë, Sh.a U Elbasan Fshat dhe Sh.a U Poliçan. Për këto shoqëri procesi për miratimin e tarifave kishte filluar sipas aplikimeve për ndryshimin e tarifave të paraqitura në vitin 2014 (*kërkesa për ndryshimin e tarifës e paraqitur nga operatorët UK për vitin 2015 dhe ajo e miratuar nga KKRR është paraqitur në detaje në Aneksin 2*).

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimmarrjen e tij :

- miratoi ndryshimin e tarifave për Sha UK Ersekë, Sha UK Sarandë, Sha U Elbasan Fshat dhe Sha U Korçë Fshat.
- nuk miratoi ndryshimin e tarifave për Sha U Poliçan dhe Sha UK Korçë Qytet. Nga analizat përkatëse në lidhje me kërkesën e paraqitur për ndryshimin e tarifave rezultoi se ndryshimi i kërkuar i tarifave nga këto shoqëri nuk ishte i justifikuar.
- vendosi të mos marrë në shqyrtim propozimet për ndryshim tarife për vitin 2015 për shoqëritë Sh.a UK Lezhë, Sh.a UK Krujë, Sh.a UK Gjirokastrë, Sh.a UK Fier, Sh.a UK Kukës dhe Sh.a UK Lushnjë Qytet. Këto shoqëri, nuk plotësuan dokumentacionin e aplikimit në përputhje me kërkesat e Ligjit 8102 dhe Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave". Në zbatim të metodologjisë, këtyre shoqërive ju kërkua riparaqitja e aplikimit për ndryshimin e tarifave e plotësuar me dokumentacionin e munguar dhe me të dhëna të përditësuara.

Në zbatim të metodologjisë, procesi i miratimit të tarifave përfshin analizën e kostove dhe performancës, duke i caktuar operatorëve objektiva të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

Metodologjia krijon një lidhje direkte ndërmjet ndryshimit të tarifave dhe performancës së operatorëve në mënyrë që eficaenca në ofrimin e shërbimeve në sektor të rritet. Ajo bazohet në parimet e mëposhtme:


<p>Mbulimi i Kostove</p>	<p><i>Procesi tarifor trajtohet duke pasur parasysh objektivat e politikës tarifore: Tarifat rriten gradualisht derisa arkëtimet të mbulojnë të gjitha kostot, përfshi amortizimin dhe interesat e huave.</i></p>
<p>Efikasiteti menaxhues</p>	<p><i>Ofruesit e shërbimit duhet të demonstrojnë progres të matshëm në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare para se ERRU të miratojë rritje tarifash.</i></p>
<p>Përballueshmëria</p>	<p><i>Familjet me të ardhura të ulta duhet të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat bazë të konsumit duke shpenzuar jo më shumë se 5 % e të ardhurave të tyre për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.</i></p>
<p>Efikasiteti mjedisor</p>	<p><i>Struktura e tarifave duhet të nxisë ruajtjen e burimeve dhe nivele të qëndrueshme konsumi.</i></p>

○ *Mbulimi i kostove*

Enti Rregullator i Ujit ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e të gjithë operatorëve për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, për të siguruar cilësinë, efikasitetin dhe vijueshmërinë e shërbimeve që ato ofrojnë për të gjithë konsumatorët.

Shoqëritë duhet të arrijnë të mbulojnë kostot e shërbimeve që ofrojnë me të ardhurat nga aktiviteti i tyre. Tarifa luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Ndryshimi i tarifave ka patur përgjithësisht tendencë rritëse, në varësi të kushteve dhe zhvillimeve të ofrimit të shërbimit të çdo operatori. Në sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka ende shoqëri që operojnë me tarifa të ulta, por që arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e tyre më pak se gjysmën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Nga ana tjetër dhe infrastruktura ekzistuese e shërbimeve UK ka nevojë për rehabilitim, zëvendësim ose shtrirje të mëtjshme, pasi sektori është në proces përmirësimi dhe zgjerimi për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Gjithashtu, trajtimi i ujërave të ndotura mbetet një fushë prioritare duke pasur parasysh angazhimet që Shqipëria ka për të arritur pajtueshmërinë me direktivat kryesore të BE lidhur me mjedisin. Trajtimi i ujërave të ndotura është një shërbim i kushtueshëm dhe pjesa më e madhe e investimeve janë financuar nga donatorë të huaj nëpërmjet granteve dhe kredive. Investimet nga njëra anë, luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimit për konsumatorët por mirëmbajtja e tyre dhe kostot e kredisë rrisin koston e shërbimeve.

Mbulimi i kostove totale kërkon rritje të ndjeshme të tarifave, të cilat mund të mos përballohen nga konsumatorët. Synimi i ERRU-së është së pari mbulimi i menjëhershëm i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa mbulimi i kostove totale është objektiv më i largët, i cili do të arrihet gradualisht. Rezultati i pritshëm, në mbulimin e kostove të O&M me të ardhurat nga aktiviteti i operatorëve, të cilëve u është miratuar ndryshimi i tarifave në vitin 2015 pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 3. Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes

Për Sha U Elbasan Fshat, Sha U Korçë Fshat të cilat kanë nivele të ulta të mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti, ndryshimi i tarifave do të sjellë vetëm përmirësim të shkallës së mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Për Sha U Elbasan Fshat ky përmirësim është llogaritur nga 52 % në 62% ndërsa për Sha U Korçë Fshat nga 40% në 71%.


Për Sha U Poliçan nuk u miratua ndryshimi i tarifave për vitin 2015. Treguesit e performancës së kësaj shoqërie janë në nivele të ulta. Ritja e tarifave duke mos përmirësuar shërbimin ndaj klientëve do të kishte efekte negative. Shoqërisë i është kërkuar përmirësimi i treguesve të punës duke u fokusuar në menaxhimin më efektiv të shërbimit të furnizimit me ujë.

Për vitin 2015 mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes për këto shoqëri përllogaritet për Sha U Elbasan Fshat 57% dhe për Sha U Korçë Fshat 47%. Këto rezultate kanë ardhur nga rritja e kostove dhe mosrealizimi i të ardhurave. Këto shoqëri duhet të kishin punuar më shumë për të mbajtur nënkontroll nivelin e shpenzimeve. Efektet financiare nga aplikimi i tarifave të miratuara do të ishin ato të parashikuara nëse aplikimi i tarifave të ndryshuara do të kishte filluar nga 1 Janari i këtij viti. Aplikimi i tarifave të reja për shoqëritë e sipërpërmendura ka filluar pas katërmujorit të parë dhe rezultatet e mësipërme të mbulimit të kostove janë përllogaritur mbi bazën e të dhënave të nëntëmuorit 2015.

Eksperiencia tregon se në fund të vitit rezultatet janë më pozitive pasi mobilizimi i operatorëve për të mbledhur të ardhurat është më i madh, gjë e cila ndikon edhe në shkallën e mbulimit të kostove. Efekti i zbatimit të tarifave të reja do të shihet në vitin e ardhshëm.

Për Sha UK Korçë Qytet, Komisioni Kombëtar Rregullator nuk miratoi ndryshimin e tarifave. UK Korçë sh.a kryen shërbimin e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Kostot e këtyre shërbimeve kanë ardhur duke u rritur pasi kostot e operimit dhe mirëmbajtjes së investimeve të kryera janë të larta, gjithashtu shoqëria është duke paguar edhe koston e kredive. ERRU nëpërmjet rritjes së herë pas herëshme të tarifave ka mbështetur shoqërinë për të rritur qëndrueshmërinë financiare në mënyrë që të ruhen standardet e arritura në ofrimin e shërbimit.

Nga analiza e shpenzimeve dhe të ardhurave rezultoi se shoqëria me tarifatat aktuale është në gjendje të mbulojë kostot pasi kjo shoqëri ka nivel të lartë të mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti. Duke marrë në konsideratë faktin që konsumatorët duhet të paguajnë për kostot e arsyeshme dhe të domosdoshme rritja e kërkuar e tarifave nuk justifikonte qëllimin për të cilën kërkohej.



Grafiku 4. Mbulimi i kostove totale.

Sha UK Sarandë dhe Sha UK Ersekë janë shoqëri të cilat janë duke kryer investime, burimi i financimit të investimeve janë huatë. Rritja e tarifave do të mbulojë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes si dhe koston e kredisë. Prandaj ndryshimi i tarifave është i nevojshëm dhe i domosdoshëm, pasi të ardhurat aktuale nuk i përmbushin nevojat e operatorëve për të mbuluar këto kosto.

○ *Efikasiteti menaxhues*

Vetëm rritja e tarifave, megjithëse sjell më shumë të ardhura për operatorët, nuk është e mjaftueshme nëse nuk përmirësohet ofrimi i shërbimit. Konsumatorët do të paguajnë më shumë për një shërbim jo cilësor. Për këtë arsye, politika tarifore e ndjekur nga ERRU përfshin si pjesë të këtij procesi edhe analizën e progresit në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare, e cila do të çojë në rritjen e mbulimit të kostove.

ERRU ka përzgjedhur 10 tregues kryesorë (TKP) për të vlerësuar performancën e operatorëve. Këta tregues pasqyrojnë një pjesë të madhe të detyrave që operatorët duhet të kryejnë në mënyrë që shërbimet që ato ofrojnë të jenë cilësore dhe efçente.

Miratimi i tarifave përfshin si pjesë të këtij procesi edhe përcaktimin e objektivave për 10 TKP që operatori duhet të arrijë për përmirësimin e shërbimit. Përpara çdo ndryshimi të kërkuar të tarifave bëhet vlerësimi i realizimit të këtyre objektivave. Në varësi të rezultateve të arritura procesi i miratimit të tarifave përfshin stimuj për operatorët që kanë përmirësuar performancën

e tyre duke ofruar shërbime më të mira ose penalizim për ata që nuk kanë mundur të realizojnë objektivat.

Mbulimi i kostove nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përpjekjet sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik. KKRR për "UK Sarandë" sha dhe "UK Ersekë" analizoi realizimin e objektivave për vitin 2014, të përcaktuara me miratimin paraardhës të tarifave. Objektivat për treguesit kryesorë të performancës janë vendosur nga KKRR dhe pranuar nga operatori me nënshkrimin e kontratës për zbatimin e tarifave të miratuara.

Operatorët duhet të shikojnë mundësinë për të ulur shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes sidomos në ato zëra që zënë edhe peshën specifike më të madhe të këtyre shpenzimeve. Ulja e humbjeve, rritja e nivelit të faturimit, vendosja e matësave, përmirësimi i normës së arkëtimit, rritja e efikasitetit të stafit, përmirësimi i efijencës së energjisë janë tregues ku menaxhimi me profesionalizëm luan një rol të rëndësishëm.

Nga analiza rezultoi se operatorët nuk i kishin arritur të gjitha objektivat e përcaktuara nga KKRR.

Në vitin 2015 treguesit kryesorë të performancës nuk kanë shënuar progres të dukshëm. Shoqëritë nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të arritur objektivat. Viti 2015 ka qënë vit zgjedhor dhe ndikimi i ndryshimeve politike është reflektuar edhe në menaxhimin e shoqërive UK.

Nga ana tjetër, përllogaritja e mbulimit të kostove bazohet në të dhënat e nëntëmujorit 2015, por eksperiencat kanë treguar se situata përmirësohet në tremujorin e fundit. Shoqëritë mobilizohen më shumë për të mbledhur të ardhurat gjë e cila ndikon edhe në shkallën e mbulimit të kostove

Për periudhën në vazhdim, sektori do të reformohet gjë e cila do të sjell ndryshime edhe në organizmin dhe menaxhimin e shërbimeve ujësjellës kanalizime.

○ *Përballueshmëria e tarifave*

Gjatë viteve të fundit, aktivitetet për zhvillimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë projektuar për të çuar drejt vizionit të shërbimeve gjithëpërfshirëse të ujit për të gjithë në Shqipëri. Në vitin 2011 u miratua ‘Strategjia Kombëtare për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve’, e cila konfirmoi angazhimin e Shqipërisë për parimin që “ofrimi i ujit të pijshëm dhe shërbimeve të kanalizimeve” përbën një të drejtë të njeriut.

Një element kyç për vizionin për të ardhmen është që shërbimet e sektorit për publikun të mund të ofrohen nga operatorë që janë financiarisht të qëndrueshëm. Kostot e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të mbulohen me të ardhurat nga faturimi i shërbimeve tek konsumatorët. Kjo do të thotë se tarifat duhet të rriten për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të operatorëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Megjithatë, jo të gjithë qytetarët që përfitojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, mund të kenë burime të mjaftueshme financiare për të paguar për këto shërbime.

Në përputhje edhe me standartet ndërkombëtare, gjatë përcaktimit të strukturës së tarifave, ERRU ka parasysh aplikimin e një strukture tarifash të përballeshme për nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulta.

Në funksion të këtij qëllimi ERRU është duke përdorur disa instrumenta rregullatore si struktura tarifore, subvencioni i kryqëzuar, seanca dëgjimore me publikun, monitorimi i efikasitetit dhe efektivitetit të ofruesve të shërbimit. Nga ana tjetër edhe buxheti i shtetit ka vazhduar të subvencionojë drejtpërdrejt shoqëritë duke mbuluar kosto operative të caktuara.

Për të gjykuar nga pikëpamja e përgjithshme situatën e përballeshmërisë, ERRU gjatë përcaktimit të tarifave për të gjithë operatorët, mban gjithmonë parasysh që fatura për konsumatorët familjarë në zonën e shërbimit të operatorit, nuk duhet të kalojë 5% të të ardhurave të tyre mesatare¹.

Operatori	Vlera e faturës ² (lek/muaj)	Të ardhurat mesatare ³ për familje (lek/muaj)	Vlera e faturës / Të ardhura (%)
Sha UK Ersekë	891	42,464	2.1%
Sha U Elbasan Fshat	804	27,868	2.9%
Sha UK Korçë Qytet	1,940	42,464	4.6%
Sha U Poliçan	670	32,027	2.0%
Sha U Korçë Fshat	734	42,464	1.7%
Sha UK Sarandë	1446	48,327	3.0%

Tabela 1: Përqindja e vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për familje

Megjithatë, arritja e konkluzioneve më të drejta në lidhje me përballeshmërinë kërkon analiza më të detajuara në lidhje me të ardhurat për familje për çdo zonë, numrit të familjeve me të ardhura të ulëta në secilën prej tyre, etj.

¹ Të ardhurat mesatare të konsumatorëve familjare merret nga të dhënat e publikuara nga INSTAT.

² Përlllogaritjet janë bërë për një familje me konsum mesatar (18 m³ në muaj).

³ Të ardhurat mesatare për familje janë llogaritur sipas Qarqeve.

Përballueshmëria është e lidhur me shumë çështje, të cilat trajtohen nga disa institucione, si të ardhurat e familjeve, përcaktimin e nivelit minimal të konsumit të ujit për nevojat bazë, çfarë konsiderohet e arsyeshme për t'u shpenzuar nga një familje për shërbimet UK, eficienta dhe efektiviteti i ofruesve të shërbimit, riorganizimi i shërbimeve drejt ekonomisë së shkallës, mekanizmat e subvencionimit, etj.

ERRU është i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e tjerë për të qartësuar më tej mënyrën e trajtimit dhe të kapërcimit të çështjes së përballueshmërisë.

Gjithsesi, duhet të gjenden mekanizma të përshtatshme subvencionimi për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulta dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

○ **Mbrojtja e mjedisit**

Çështjet e mjedisit kërkojnë gjithashtu vëmendje të posaçme në rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Shërbimet ujësjellës kanalizime janë të rëndësishme nga ana sociale. Konsumatorët janë të interesuar të kenë furnizim me ujë në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe lidhje të rregullt me sistemin e kanalizimeve.

Prandaj mbrojtja e burimeve të ujit nënkupton jo vetëm zbatimin e kushteve teknike të shfrytëzimit, por edhe zgjatjen e jetëgjatësisë si rezultat i përdorimit të tyre me efektivitet. Politika e rritjes së tarifave me rritjen e konsumit të ujit ndihmon në kursimin e ujit nga konsumatorët.

Gjithashtu, vënia në funksionim e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura përmirëson cilësinë e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e mjedisit.


● **Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit**

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave, të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove, me qëllim uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundësive për shlyerjen e kredive, e lidhur kjo edhe me përmirësimin e performancës.

Prandaj, krahas ndryshimit të tarifave në vendim janë përcaktuar edhe objektivat që shoqëria duhet të arrijë për treguesit kryesorë të performancës. Për rregullatorin, vlerësimi dhe monitorimi i objektivave të vendosur, si pjesë e procesit të miratimit të tarifave, është mjaft i rëndësishëm.

Monitorimi jep mundësi të bëhet vlerësimi real i punës së çdo operatori dhe të vendosen objektiva sfiduese por të arritshme, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive.

Gjatë vitit 2015, ERRU monitoroi zbatimin dhe efektin e ndryshimit të tarifave të miratuara në vitin 2014 dhe 2015 në mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes dhe kostove totale. Rezultatet janë pasqyruar në grafikët e mëposhtëm.




Grafiku 5: Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes

Rezultatet tregojnë se shtatë nga dhjetë shoqëritë e monitoruara kanë arritur nivele të mira të mbulimit të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes, pra nëpërmjet strukturës së miratuar të tarifave është arritur objektivi i politikës tarifore. Gradualisht këto shoqëri do të arrijnë të mbulojnë edhe koston totale.

Sha U Poliçan, Sha U Korçë Fshat dhe Sha U Elbasan Fshat kanë nivel të ulët të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Për këto shoqëri përmirësimi i situatës do të kërkonte rritje të ndjeshme të tarifave gjë e cila do të ishte e papërballeshme nga konsumatorët për faktin se këto shoqëri e ushtrojnë aktivitetin në zona me të ardhura të ulta. Përmirësimi i shkallës së mbulimit të kostove nëpërmjet rritjes së tarifave do të arrihet gradualisht.

Ndonëse rezultatet në mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes janë të mira për pjesën më të madhe të shoqërive, mbulimi i kostos totale është arritur vetëm nga Sha UK Peshkopi.



Grafiku 6. Mbulimi i kostove totale

Për shoqëritë Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Berat-Kuçovë, ERRU nëpërmjet ndryshimit të tarifave po synon rritjen e të ardhurave, jo vetëm për të mbuluar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, por edhe koston totale.

Në vite këto shoqëri kanë kryer investime, financimi i të cilave është bërë nëpërmjet kredive, kështu që aktualisht ato janë të detyruara të paguajnë edhe kostot e kredisë.

Së fundmi në listën e këtyre shoqërive është shtuar edhe Sha UK Ersekë. Investimi i kryer për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë ka rritur kostot, gjë e cila ka ndikuar edhe në uljen e shkallës së mbulimit të kostove me të ardhura. Shoqëria i ka realizuar të ardhurat dhe shpenzimet sipas parashikimeve të bëra në aplikimin për ndryshimin e tarifave.

Për Sha U Elbasan Fshat, Sha U Korçë Fshat dhe Sha U Poliçan mbulimi i kostove totale është një objektivi i largët. Këto shoqëri së pari duhet të arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

Rritja e shkallës së mbulimit të kostove të shërbimeve nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përmirësimi i menaxhimit, duke rritur efikasitetin operacionale në lidhje me faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave si dhe kontrollin e kostove.

Për të vendosur një raport sa më të mirë ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave, shoqëritë duhet të punojnë si për të rritur të ardhurat ashtu dhe për të ulur kostot e shërbimeve.

	Kostot OM dy shërbimet	Kostot OM dy shërbimet	Kostot Totale dy shërbimet	Kostot Totale dy shërbimet	Të ardhurat nga aktiviteti	Të ardhurat nga aktiviteti
	2014	2015	2014	2015	2014	2015
000 Lek	1,053,311	1,111,728	1,503,438	1,585,998	1,281,381	1,303,235
000 Euro (kursi 140)	7,523.65	7,940.91	10,738.84	11,328.55	9,152.72	9,308.82

Tabela 2. Kostot dhe të ardhurat për operatorët që ju është miratuar ndryshimi i tarifave në vitin 2015

Nga analiza e të dhënave në lidhje me kostot dhe të ardhurat për shoqëritë që kanë aplikuar tarifën e ndryshuar rezultojnë se kostot për shërbimet UK në vitin 2015 janë rritur rreth 5% krahasuar me vitin 2014, ndërsa të ardhurat janë rritur rreth 2%.

Rritja e të ardhurave do të ishte më e lartë nëse aplikimi i tarifave të ndryshuar do të kishte filluar nga 1 janari i vitit 2015. Aplikimi i tarifave të reja për Sha UK Ersekë, Sha UK Sarandë, Sha U Elbasan Fshat, dhe Sha U Korçë Fshat ka filluar respektivisht në muajt prill, maj, qershor, korrik.

Sha UK Sarandë dhe Sha UK Korçë Qytet kanë përmirësuar mbulimin e kostove si rezultat jo vetëm i rritjes së të ardhurave, por edhe i uljes së kostove.

Për Sha U Elbasan Fshat, Sha U Korçë Fshat, Sha UK Peshkopi, Sha U Poliçan, Sha UK Ersekë, Sha UK Fier dhe Sha UK Lushnje krahas rritjes së të ardhurave vëhet re edhe rritje e kostove.

Ndërsa për Sha UK Berat Kuçovë, mbulimi i kostove është ulur si rezultat i rritjes së kostove dhe uljes së të ardhurave.

Pjesë e monitorimit është gjithashtu performanca e operatorëve e vlerësuar në bazë të treguesve kryesorë të performancës.

ERRU ka vlerësuar realizimin e objektivave për TKP të përcaktuar nga ERRU për shoqëritë të cilave ju është miratuar ndryshimi i tarifave në vitin 2014 dhe 2015.

INDIKATORËT	Njësia	Elbasan fshat UK Sh.A		Ersekë U Sh.A		Korçë fshat U Sh.A		Sarandë U Sh.A	
		Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi
Uji pa të ardhura	%	29%	34%	55%	47%	29%	32%	60%	77%
Niveli i matjes	%	70%	55%	73%	67%	67%	43%	80%	65%
Kohëzgjatja e furnizimit	orë/ditë	16	18.10	21	17.58	13	12.21	8	5.32
Efienca e energjisë	kwh/m3	2.31	2.06			1.2	1.80	0.68	0.79
Efikasiteti i stafit	staf/1000 lidhje	13	12.36	5.5	7.33	7.8	7.95	3.38	3.68
Mbulimi me ujë	%	60%	57%	100%	100%	66%	80%	97%	100%
Mbulimi me kanalizime	%			100%	85%			76%	75%
Norma e arkëtimit	%	97%	113%	94%	104%	94%	84%	85%	82%

Tabela 3. Treguesit e Performancës për operatorët që kanë marrë tarifa në vitin 2015

INDIKATORËT	Njësia	Berat Kuçovë UK		Fier UK Sh.A		Lushnje UK Sh.A		Peshkopi UK Sh.A ⁴	
		Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi
Uji pa të ardhura	%	70	76	60	63	65	79		61
Niveli i matjes	%	53	45	60	55	99	79		29
Kohëzgjatja e furnizimit	orë/ditë	11	9.47	22	20	8	4.7		7.56
Efienca e energjisë	kwh/m3	1.83	1.76	0.78	1.17	0.58	0.6		0.00
Efikasiteti i stafit	staf/1000 lidhje	5.3	5.4	4.4	6.4	5.9	5.9		6.00
Mbulimi me ujë	%	90	90	96	92	85	67		100
Mbulimi me kanalizime	%	75	72	62	62	70	50		42
Norma e arkëtimit	%	85		75	79	85	94		72

Tabela 4. Treguesit e Performancës për operatorët që kanë marrë tarifa në vitin 2014

Rezultatet tregojnë se shoqëritë përgjithësisht nuk kanë arritur objektivat e përcaktuara, gjë e cila reflektohet edhe në rezultatet e mbulimit të kostove. ERRU do të vazhdojë të mbështesë dhe nxisë shoqëritë UK për të përmirësuar treguesit e punës, për të rritur qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

⁴ Sha UK Peshkopi ka aplikuar për herë të parë për tarifa pranë ERRU-së në vitin 2014. Për këtë arsye kolona "Objektivi" është pa të dhëna

- **Përmirësimi i standarteve në sektorin UK nëpërmjet instrumentave rregullatore**
- *Rishikimi i Politikës Tarifore dhe Metodologjisë për ndryshimin e tarifave*

Nisur nga eksperiencia e deritanishme e zbatimit të Metodologjisë "Për Vendosjen e Tarifave" për shërbimet UK dhe zhvillimeve aktuale në sektorin ujësjellës kanalizime, ERRU ndërmori nismën për rishikimin e kësaj metodologjie.

Në metodologjinë ekzistuese pjesa e politikës tarifore, metodologjia për llogaritjen e tarifave si dhe procesi i miratimit të tarifave, janë pjesë e të njëjtit dokument. ERRU, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe me mbështetjen e GIZ, ripunoi Metodologjinë "Për vendosjen e tarifave", duke përcaktuar në dokumenta të veçantë për:

- Politikën tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujrave të ndotura.
- Metodologjinë "Për vendosjen e tarifave" për shërbimet UK
- Dokumentacionin e aplikimit për ndryshimin e tarifave për shërbimet UK
- Procesin e miratimit të tarifave për shërbimet UK.

Mandati i ERRU-së i përcaktuar në Ligjin Nr. 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, është mbrojtja e konsumatorëve duke vendosur stimuj që inkurajojnë efikasitetin dhe përmirësimet e ofrimit të shërbimit të konsumatorëve, por dhe duke u mundësuar operatorëve mbulimin e të gjitha kostove të arsyeshme që lindin nga ofrimi i këtyre shërbimeve. Tarifat janë vendimtare për arritjen e këtij ekuilibri, si edhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit në tërësi.

Në dokumentin "Politika tarifore për shërbimet UK", ERRU ka përcaktuar drejtimet kryesore për përmbushjen këtij objekti, të cilat duhet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata.

Nivel i tarifës bazohet në Politikën Tarifore dhe përcaktohet sipas "Metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujrave të ndotura".

Metodologjia e llogaritjes së tarifave për shërbimet ujë i pijshëm, grumbullim, largim dhe trajtim i ujrave të ndotura është një dokument që synon lehtësimin e vendosjes së tarifave të

shërbimeve në këtë sektor. Ky dokument përmirësohet për atë që konsiderohet e nevojshme nga ana e rregullatorit, dhe komunikohet me operatorët në lidhje me ndryshimet e bëra.

ERRU angazhohet të zbatojë drejtë dhe saktë metodologjinë dhe të kontribuojë në trajnimin e operatorëve në lidhje me përdorimin e kësaj metodologjie.

Nëpërmjet Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave" ERRU synon vënien në jetë të politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura, miratuar me vendim të KKRR.

Bazë për vlerësimin e aplikimit për nivelin e tarifës së shërbimeve Ujësjetellës Kanalizime është "Metodologjia për vendosjen e tarifave" dhe "Justifikimi i nivelit të kërkuar të tarifës-Modeli i aplikimit", të cilat përgatiten sipas një procesi, manualeve përkatëse për përdoruesit dhe dokumentave tip të përgatitura dhe vënë në dispozicion për operatorët nga ERRU.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë prezantuar dhe dy manuale, të hartuara me mbështetjen GIZ, të cilat do të ndihmojnë procesin e miratimit të tarifave. Në muajin Nëntor ekspertët i prezantuan ato në trajnimin e zhvilluar për ERRU dhe përfaqësues të disa shoqërive. Pas miratimit nga Komisioni Kombëtar Rregullator ato do të jenë pjesë e Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave"

Manuali "Justifikimi i Investimeve", ndihmon të kuptohet pse një investim është i nevojshëm dhe financimi i tij është përdorimi eficient dhe i mirë i parave të pagesve, përmirëson procesin e hartimit dhe zbatimit të investimit si dhe ndihmon krijimin e besueshmërisë tek publiku për pranimin e politikave tarifore.

Manuali "Kontabiliteti i kostos për shërbimin e trajtimit të ujrave të ndotura", udhëzon se si sistemi i informacionit të kontabilitetit mund të ndihmojë drejtuesit e shoqërive ujësjetellës kanalizime me informacion të besueshëm dhe të standartizuar mbi kostot e trajtimit të ujrave të ndotura në impiant dhe burimet e financimit në dispozicion.

Në dokumentin "Dokumentacioni i aplikimit për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura", qartësohet për të interesuarit se cili është dokumentacioni i nevojshëm dhe i domosdoshëm për paraqitjen e aplikimit për ndryshimin e tarifave.

Gjatë vitit 2015, me qëllim lehtësimin e punës për operatorët që aplikojnë për ndryshimin e tarifave, ERRU miratoi paketën e dokumentave tip që nevojiten për plotësimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga operatorët në faqen e web-it të ERRU.

Dokumenti " Procesi i miratimit të tarifave për shërbimet UK", përshkruan detyrat dhe afatet e kryerjes së procedurave, për plotësimin e aplikimit, paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave, si për shoqëritë ujësjellës kanalizime por edhe për vet Entin Rregullator të Ujit.

Objektivi kryesor është që nëpërmjet këtyre dokumentave shoqëritë ujësjellës kanalizime të aplikojnë për ndryshimin e tarifave më me lehtësi, ndryshimet e kërkuara të tarifave, të jenë të justifikuara dhe në përputhje me politikën tarifore.

○ *Sistemi i raportimit rregullator*

Baza e krijimit të sistemit rregullator ishte zbërthimi i objektivave të ERRU-së që dalin nga ligji 8102 dhe strategjia ndërsektoriale 2011-2017, në kriteret për t'u vlerësuar.

Gjatë vitit 2015, ERRU në bashkëpunim me GIZ ka përfunduar projektin për krijimin e një "Sistemi të raportimit rregullator". Sistemi i cili do të përdoret për këtë raportim rregullator është SIGMA, i hartuar nga eksperti ndërkombëtar, Z. Enrique Cabrera, bashkëautor i manualeve të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA) për praktikatat më të mira për indikatorët e performancës dhe benchmarking në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Në 2015, stafi i ERRU-së ndoqi 8 seanca trajnimi on-line mbi sistemin SIGMA dhe përpunimin e të dhënave në këtë sistem, procedurat dhe mënyrat e grumbullimit dhe vlerësimit të të dhënave. Sistemi do të jetë i aksesueshëm nga ndërmarrjet on-line dhe kushtojë përdorues informacioni. Testimi i sistemit ka rezultuar pozitiv dhe të dhënat historike janë vendosur tashmë që nga viti 2008.

Për periudhën në vazhdim ERRU do të vazhdojë me trajnimin e shoqërive UK me qëllim që të dhënat e raportuara të jenë sa më të sakta e të besueshme.

Monitorimi duhet të bazohet në të dhëna të sakta, të besueshme dhe të grumbulluara në kohë, të cilat do të mundësojnë një planifikim të mirë, një krahasim kuptimplotë të performancës së shoqërive, i cili rrjedhimisht të çon në një aktivitetet rregullator më efektiv.

○ *Ndryshimi i kontratës model*

Në fillim të vitit 2015, Enti Rregullator i Ujit në bashkëpunim me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorëve ndërmorën procesin e rishikimit të kontratës model për shërbime ujësjellës-kanalizime.

Gjatë punës për përmirësimin e kontratës, ERRU ka parë të arsyeshme se disa pika të kësaj kontrate kanë nevojë të ndryshohen. Kjo vjen jo vetëm në kuadër të përshtatjes me legjislacionin në fuqi por edhe me zhvillimet në sektor dhe përmirësimin e gjuhës së përdorur aty ku ishte e nevojshme.

Gjithashtu Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit bëri disa propozime konkrete për rishikimin e kontratës, kryesisht për matjen e konsumit të ujit dhe mbi përgjegjësitë e palëve në procesin e verifikimit të matësit.

Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU pas disa takimeve konsultuese miratoi me vendimin nr. 25, datë 08.07.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën model të shërbimeve ujësjellës kanalizime", ndryshimet në kontratën model, të cilat synojnë të përmirësojnë këto çështje të marrëdhënies mes klientëve dhe operatorëve:

- *Matja* - Si problemi më i ndjeshëm në marrëdhënien mes klientit dhe operatorit, u riformuluan nenet mbi procedurat për verifikimin e matësve, detyrimin për kryerjen e këtij shërbimi, pagesat dhe afatet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- *Miratimi i tarifave* - U riformulua neni për procesin e miratimit të tarifave nga ERRU, detyrimi i operatorëve për njoftimin e klientëve nëpërmjet një seance dëgjimore kur operatorët do të aplikojnë për ndryshimin e tarifave si dhe koha e hyrjes në fuqi të tarifave të reja.
- *Kamatëvonesa* - U shtua një nen mbi mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesës dhe u specifikuan rastet kur ajo aplikohet.
- *E drejta e ankesës* - U rishikua afati brenda të cilit klienti ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë operatorit dhe u saktësua kompetenca e ERRU-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes klientëve dhe operatorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

○ *Seanca dëgjimore*

Lidhur me funksionin e mbrojtjes së konsumatorit, një hap i rëndësishëm gjatë vitit 2015 është miratimi nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU i Udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

ERRU duke dashur të sigurohet që konsumatori është i përfshirë në procesin e ndryshimit të tarifave, parashikoi në udhëzues procedura të qarta që shoqëritë duhet të ndjekin në organizimin e seancës dëgjimore.

Procesverbali i Seancës dëgjimore me publikun është një dokument i domosdoshëm në procesin e aplikimit për ndryshim tarife. Mungesa e këtij dokumenti në dosjen e aplikimit bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU. Për këtë arsye ishte e rëndësishme që të specifikoheshin shumë qartë afatet, rregullat dhe personat përgjegjës pranë shoqërisë për organizimin e seancës dëgjimore.

Në udhëzues u sanksionua që seanca të jetë e hapur dhe për pjesëmarrjen në të duhet të merren masa për njoftimin e të gjithë konsumatorëve që marrin shërbim nga operatori. Thelbi i organizimit të saj mbetet informimi dhe diskutimi me konsumatorët lidhur me ndryshimin e tarifave, arsyet e këtyre ndryshimeve, investimet, planet për të ardhmen si dhe marrjen e komenteve nga palët e interesuara lidhur me këto propozime. Në këtë mënyrë ERRU synon përmirësimin e nivelit dhe transparencës dhe llogaridhënia ndaj konsumatorit në sektorin ujësjellës - kanalizime.

Gjatë vitit 2015, shoqëria Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. aplikoi e para Udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun, si pjesë e procesit të aplikimit për ndryshimin e tarifave. Në këtë seancë ERRU pati mundësinë të shikojë nga afër zbatimin në praktikë të udhëzuesit dhe të provojë se kjo procedurë e organizuar dhe e ndjekur sipas saj, e përmirëson ndjeshëm mundësinë e përfshirjes së publikut në procesin e rëndësishëm të ndryshimit të tarifave.

○ *Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm*

Ky standard, cilësia e ujit të pijshëm në Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të jetë një çështje mjaft e ndjeshme që lidhet direkt me standardin e shërbimit ujësjellës e kanalizime. ERRU e ka vlerësuar si tepër të rëndësishëm procesin e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm që furnizohet për konsumatorët, informimin dhe mbrojtjen e tyre, si edhe raportimin dhe shkëmbimin e informacionit mes të gjitha hallkave të duhura institucionale lidhur me cilësinë e ujit. Në maj 2014, Enti Rregullator i Ujit, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi, për raportimin dhe shkëmbimin e informacioneve mbi cilësinë e ujit të pijshëm që furnizon konsumatorët, nëpërmjet sistemeve të ujësjellësve.

Me këtë marrëveshje, siç është theksuar në Raportin Vjetor 2014, ERRU synonte që procedurat mbi testimin dhe raportimin në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm të ndryshonin duke ju referuar standardit kombëtar të cilësisë së ujit të pijshëm dhe formatit të ri në Excel të miratuar.

Në përmbushje të detyrimeve të ndërsjellta të përcaktuara në këtë akt marrëveshje, ERRU nën mbështetjen e GIZ zhvilloi trajnime të stafit të laboratorëve të gjithë DRSH/DSHP dhe të shoqërive UK. Nga raporti i përgatitur në përfundim të këtyre trajnimeve një nga problematikat kryesore ishte mungesa e laboratorëve dhe kiteve testues dhe metodave të vjetra të kryerjes së analizave. Në ndihmë të rritjes së kapaciteteve laboratorike GIZ investoi edhe në blerjen e 4 laboratorëve të lëvizshëm për ISHP-në.

Me gjithë punën e bërë nga ana e institucionit tonë, monitorimi dhe raportimi mbi cilësisë së ujit të pijshëm sipas marrëveshjes të bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe ISHP nuk është arritur. Megjithëse përpjekjet tona kanë qenë të vazhdueshme, duke mbajtur kontakte si verbale ashtu edhe shkresore me autoritetin ligjor për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, me ISHP-në e Ministrinë e Shëndetësisë, prej tyre nuk kemi patur reagim.

1.4. Konsolidimi institucional

Enti Rregullator i Ujit luan një rol thelbësor në sektor, për sa i përket përcaktimit të politikave të drejta dhe të paanshme tarifore, orientimit të shërbimeve UK drejt mbulimit të kostove dhe drejt ekonomisë së shkallës.

Përveç këtij roli, ekzistenca e një institucioni rregullator në sektor, shërben për rritjen e transparencës dhe shkallës së informimit të publikut dhe qeverisjes rreth zhvillimeve të sektorit UK, duke shërbyer kështu si një burim alternativ i informacionit, i benchmarking dhe i shqyrtimit e vlerësimit të shërbimeve UK.

ERRU gjatë përmbushjes së detyrave që i përcakton ligji, udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë dhe gjetjes së ekuilibrit mes interesave të gjithë palëve në sektorin UK, konsumatorëve, operatorëve të shërbimeve, qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore dhe investitorëve.

- **Problematikat në lidhje me kuadrin ligjor të ERRU**

Me qëllim forcimin institucional të ERRU, ka nisur procesi për ndryshimin e ligjit të funksionimit të ERRU. Ky proces ka nisur në vitin 2012 dhe për këtë qëllim është ngritur edhe një grup pune ndërministror, i udhëhequr nga Ministria e linjes në atë kohë. Ky proces ka vazhduar deri në vitin 2015 ku janë rimarrë mendimet nga të gjithë pjesëtarët e këtij grupi ndërministror.

Qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve është kalimi nën kompetencën e ERRU-së dhe të miratimit të tarifave të depozitimit të mbetjeve jo të rrezikshme në landfille dhe në impiantet e incenerimit. Ky propozim mbështetet me argumentin se aktualisht depozitimi i këtyre mbetjeve nuk është i rregulluar ligjërisht përse i përket anës ekonomike të përcaktimit të tarifave të depozitimit të tyre në landfille.

Përveç këtij aspekti, në draftin e ligjit janë bërë edhe disa shtesa dhe ndryshime, të cilat kanë lindur si nevojë gjatë ushtrimit të rolit dhe mandatit të ERRU gjatë viteve. Këto ndryshime kanë si qëllim kryesor përcaktimin e një pavarësie të qartë institucionale të ERRU dhe forcimin e rolit të tij nëpërmjet:

- miratimit të anëtarëve të komisionit kombëtar rregullator nga Kuvendi,
- rritjes së pavarësisë financiare;
- rritjes së rolit të Entit në mbrojtjen e konsumatorëve;
- si edhe rritjes së masës së sanksioneve ndaj operatorëve që shkelin detyrimet ligjore.

Ndryshimet e propozuara përputhen gjithashtu edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017.

Edhe pse po bën një kohë e gjatë që ky proces ka nisur, këto ndryshime vijojnë të mbeten pezull. Drafti i ligjit është produkt i një grupi ndërministror punë dhe është rikonsultuar me të gjitha ministrinë që kanë në fushën e veprimit të tyre çështje të ujit në vitin 2014.

Ky draft ishte përfshirë në punimet e Kuvendit në vjeshtën e vitit 2015, por u tërhoq nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Deri më tani, institucioni i ERRU-së mbetet i painformuar mbi arsyet e tërheqjes së draftit të ligjit.

Mungesa e transparencës, tejzgjatja pa arsye e këtij procesi dhe mos miratimi i këtyre ndryshimeve, sigurisht që nuk përmirëson punën e ERRU, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit.

Lidhur me çështjen e ndryshimeve ligjore, ERRU vazhdimisht e ka paraqitur këtë problematikë në raportimin vjetor në Kuvend, si edhe në çdo komunikim zyrtar me institucionet si Këshilli i Ministrave, Sekretariati i Ujit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, etj.

Gjykojmë se përfundimi i këtij procesi, do të shërbejë për t'i dhënë një tjetër dimension funksional ERRU-së.

Këto ndryshime priten t'i japin ERRU-së, nga njëra anë, pavarësinë e nevojshme për një rregullator dhe nga ana tjetër i njohin një rol aktiv dhe përfshirës në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit.

Ndryshimet e propozuara në ligj pritet të rregullojnë një aspekt tepër të rëndësishëm në marrëdhënien me konsumatorin, sepse i japin ERRU-së si institucion i pavarur, të drejtën për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve. Kjo siguron mbrojtjen e të drejtave të tyre përballë veprimeve të njëanshme, ose mosveprimeve të operatorëve të shërbimit.

Ky proces mbetet një nga problemet më të ndjeshme në marrëdhënien mes ERRU-së dhe konsumatorëve, i cili ka jo pak vështirësi në trajtim. Çështja e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave mbetet një çështje e pa adresuar si duhet. Parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, disa prej të cilave janë të vjetra në kohë, nuk i përgjigjen zhvillimeve aktuale dhe nuk rregullojnë plotësisht të drejtat e detyrimet e palëve.

Një ndryshim tjetër i nevojshëm ka të bëjë me forcimin e kuadrit të masave administrative ndaj operatorëve të shërbimeve UK. Masat administrative aktuale janë të pa përfillshme dhe nuk justifikojnë raportin mes shkeljes së kryer dhe penalteteve.

Për këto arsye, ndryshimet e sipërpërmendura nuk duhet të mbeten jashtë vëmendjes dhe duhet të finalizohen në një kohë sa më të shpejtë, për të përmbyllur një proces të tej zgjatur tashmë e që nuk ndihmon në aspekt të konsolidimit institucional të rregullatorit.

- **Bashkëpunimi me aktorët në sektor**

Bashkëpunimi me institucionet në vend edhe ato ndërkombëtare, veprimtaria e të cilave lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin rregullator shërben për krijimin e një frymë të mirë bashkëpunimi dhe për këtë arsye i kushtohet një vëmendje e veçantë.

ERRU në mënyrë konstante ka vijuar bashkëpunimin me të gjitha institucionet qendrore e lokale, donatorët, organizmat ndërkombëtare, shoqatat e konsumatorëve, etj.

- *Bashkëpunimi me shoqëritë UK dhe pronarët e tyre*

ERRU përgjatë gjithë viteve të kaluara ka ofruar bashkëpunim dhe ndihmën e tij për të gjithë shoqëritë UK që operojnë në sektor.

Viti 2015 shënoi një ndryshim madhor në organizimin territorial administrativ dhe uljen e numrit të njërive vendore. Pothuaj të gjitha shoqëritë UK janë prekur nga kjo reformë, duke ndryshuar aksionerët. Për njohjen e situatës së ndryshuar të pronësisë dhe problemeve e vështirësive praktike që rezultojnë si pasojë e organizimit territorial ERRU ka ndërmarrë

takime me njësite e reja vendore dhe operatorët, duke synuar në sqarimin e pozitës së tyre ligjore dhe njohjen e procedurave për rregullimin e shërbimit UK.

Qëllimi kryesor i ERRU ka qenë dhe është rregullimi i të gjithë shoqërive, si në lidhje me licencimin e tyre duke u përpjekur që ti përfshijë ato nën kuadrin rregullator, ashtu edhe në drejtim të politikës tarifore.

Për të dyja këto aspekte ERRU ka nevojë për një bashkëpunim të gjithë institucioneve në sektor, duke e pasur të pamundur të veprojë i shkëputur. Roli i njësite vendore duhet të jetë më aktiv në këtë drejtim, pasi këto njësi janë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe mirëadministrimin e shoqërisë, si pronarë të tyre. Siç u përmend dhe më lart, ERRU ka nisur një proces komunikimi me të gjithë njësitë e reja vendore, me qëllim saktësimin e të drejtave dhe detyrave që këto njësi kanë në raport me shërbimin, njohjen me kuadrin ligjor rregullator, funksionin UK, etj.

Në këtë drejtim do të ndihmojë edhe ligji i ri për organizimin e pushtetit vendor që pritet të hyjë në fuqi së shpejti.

○ *Bashkëpunimi me Institucione Ndërkombëtare*

Efektiviteti dhe kontributi i rregullatorit në sektorin e ujit, rritja e kapaciteteve institucionale të ERRU-së janë mbështetur edhe gjatë vitit 2015 nga bashkëpunimi dhe marrëdhëniet efektive me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, rregullatorët homologe dhe donatorët që japin kontributin e tyre në sektorin e ujit në Shqipëri

Drejtimet kryesore ku fokusohet bashkëpunimi ynë me institucionet ndërkombëtare janë bashkëpunimi me donatorët që japin kontributin e tyre në sektorin e ujit në Shqipëri, shkëmbimi i eksperiencave me rregullatorët homologë si dhe sigurimi i një roli aktiv si anëtarë në organizata ndërkombëtare në fushën e ujit.

Ndaj, edhe gjatë vitit 2015, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me GIZ si një partner serioz dhe një faktor mbështetës shumë i rëndësishëm për ngritjen institucionale të ERRU-së. Ky vit, shënoi fundin e projektit të mbështetjes institucionale dhe bashkëpunimit teknik të dhënë nga GIZ që nga viti 2009. Ky projekt pati një rëndësi mjaft të madhe për mbështetjen dhe konsulencën e dhënë në kuadër të forcimit institucional të ERRU-së dhe ekzekutimit të mandatit ligjor të rregullatorit.

Gjithashtu një bashkëpunim i rëndësishëm ka qenë me Bankën Botërore në kuadër të Programit të Danubit për shërbimet e ujit, shoqatën e Vendeve të Danubit.

ERRU vijon të ketë një bashkëpunim të frytshëm në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave rregullatore me Rrjetin European të Rregullatorëve të Ujit (WAREG). Në vitin 2016, takimi i ardhshëm i Asamblesë së Përgjithshme të WAREG, do të mbahet në Tiranë.

Enti Rregullator i Ujit është anëtarë me të drejta të plota në Shoqatën Ndërkombëtare të Ujit (IWA), bashkëpunon me Shoqatën Rregullatore Rajonale të Energjisë (ERRA), tashmë e fokusuar edhe në çështjet e ujit, si edhe me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, OECD, si pjesë e rrjetit të rregullatorëve ekonomik në Europë.

ERRU, në kuadër të bashkëpunimit me rregullatorë homologe nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin e Industrisë së Ujit të Skocisë. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka në fokus zgjerimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve rregullatore, zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale dhe gjithashtu do të ndihmojë në bashkëpunimin në kuadër të organizmave rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit ekonomik të sektorit ujësjellës kanalizime.

1.5. Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së

• Burimet e financimit të ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 janë pagesat e rregullimit, pagesat për licencimet dhe donacionet.

Komisioni Kombëtar Rregullator, duke paraparë situatën financiare të operatorëve, për vitin 2015, në përputhje me parimin e barazisë, ka miratuar pagesa rregullatore në përqindje të barabartë të të ardhurave të pritshme të operatorëve dhe në nivelin më të ulët të përcaktuar në “Metodologjinë për vendosjen e tarifave” .

Gjatë këtij viti ka vijuar mbështetja financiare nga projekti i qeverisë Gjermane nëpërmjet GIZ. Konkretisht Enti është mbështetur me financime për:

- studime të ndryshme të lidhura me rishikimin e dokumentave rregullatore;
- botimin e Raportit vjetor të performacës;
- zhvillimin e aktiviteteve në kuadrin e bashkëpunimit e shkëmbimit të eksperiencave me institucione të huaja ndërkombëtare, etj.

Të ardhurat e realizuara për vitin garantuan tërësisht mbështetjen financiare dhe mbulimin e shpenzimeve vjetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të Entit, pavarësisht se të ardhurat e parashikuara nuk u realizuan tërësisht. Mosrealizimi i të ardhurave vjetore të planifikuara, sjell si rrjedhojë rritjen e detyrimeve të rregullatorit ndaj buxhetit të shtetit.

Për vitin 2015, të ardhurat totale të realizuara nga burimet e financimit, janë 39 652 000 lekë, prej të cilave 39 312 000 lekë janë nga pagesat rregullatore dhe 340 000 lekë nga pagesat për licencimet.


Pavarësisht se me të ardhurat e realizuara, janë mbuluar tërësisht shpenzimet vjetore, përqindja e arkëtimit të pagesave rregullatore për vitin 2015, krahasuar me arkëtimet në vitin 2014 është më e ulët. Në vitin 2014 janë arkëtuar mbi 50 milion lekë ose 10 milion lekë më shumë se në vitin 2015.

• Shpenzimet operative

Plani vjetor i shpenzimeve të ERRU-së propozohet nga ai vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. ERRU në hartimin e planit vjetor të shpenzimeve, kushtëzohet edhe nga mundësitë e tij për realizimin e të ardhurave, që vështirësohet në kushtet e gjëndjes ekonomike financiare të një pjese të mirë të shoqërive UK.

Përmbushja e detyrimeve ligjore të ERRU-së në kuadër të reformës administrative, realizimi i objektivave vjetore për rregullimin e vazhdueshëm të sektorit UK, kushtëzojnë zgjerimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së tij dhe kërkojnë mbështetje financiare duke reflektuar rritje në shpenzimet vjetore të institucionit.

Për vitin 2015, plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, është miratuar me VKM nr. 99, datë 04.02.2015 “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2015, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. Plani vjetor i shpenzimeve operative për vitin 2015 është në shumën 39.043 500 leke dhe i detajuar paraqitet në zërat si me poshtë:



Grafiku 7. Plani vjetor i shpenzimeve operative për vitin 2015

Gjatë vitit 2015, shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit e veprimtarisë vjetore të ERRU-së janë në shumën 35 780 000 lekë, ose 92 % të fondit të planifikuar.

Të detajuara sipas zërave shpenzimet e kryera paraqiten si më poshtë:


- 21,941,000 lekë, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 3,368,000 lekë, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndëtsore.
- 10,395,000 lekë, shpenzime për shërbime e furniturë.
- 85,000 lekë, shpenzime për investime.

Përdorimi i fondeve të planifikuara, është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si për trajtimin me paga e shpërblime të të punësuarve, ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse.

Fondi i pagave e shpërblimeve është realizuar në masën 94.7% të fondit të planifikuar. Fondi i planifikuar në zërin sigurime shoqërore është realizuar në masën 100%.

Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 92 %. Me këto fonde, në përputhje me detajimin, gjatë vitit janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale logjistike e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të Komisionit dhe gjithë stafit punonjës.

Fondet e planifikuara në zërin investime janë shpenzuar në nivel shumë të ulët, mbasi në kushtet kur në muajin janar të vitit 2015 u vendos që Enti Rregullator i Ujit të zhvendosej nga ambientet ekzistuese të punës, nuk mund të kryej rikonstruksioni i parashikuar. Krahasuar me planin e miratuar nga KM, shpenzimet paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 8. Plani vjetor i planifikuar krahasuar me atë të realizuar për vitin 2015

- **Pagesa rregullatore për vitin 2015**

Pagesat e rregullimit janë detyrime ligjore e kontraktuale ndërmjet rregullatorit dhe operatorëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin Ujësjellës Kanalizime, si dhe element i domosdoshëm e tepër i rëndësishëm që garanton qëndrueshmërinë financiare të Entit Rregullator të Ujit. Ato janë burimi i vetëm i financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU-së dhe përcaktohen si pagesa rregullatore dhe pagesa për licencimet.

Për vitin 2015 pagesat rregullatore të kontraktuara ndërmjet ERRU-së dhe operatorëve janë në shumën 45 milion e 395 mijë lekë. Gjatë këtij viti operatorët kanë likujduar shumën 39 milion e 314 mijë lekë, ose 86.6 % të detyrimit.

Nga 57 operatorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektor, 14 kanë shlyer totalisht detyrimet, 12 nuk kane pagesë rregullatore dhe 31 të tjerë janë me detyrime të pashlyera edhe të viteve paraardhëse.

Ndër operatorët që kanë shlyer detyrimet rregullisht përmendim shoqëritë Bilisht, Bulqizë, Elbasan Fshat dhe Qytet, Gjirokastër Qytet, Korçë Qytet dhe Fshat, Krastë, Lezhë, Mirditë, Rubik, Sarandë, Shkodër qytet dhe Vlorë.

Duhet përmendur fakti se nga detyrimi i vitit 2015, pavarësisht arkëtimit prej 39.3 milion lekësh, vetëm 12 milion e 461 mijë lekë janë likujduar si detyrim i vitit 2015 dhe diferenca prej 26 milion e 852 mijë lekë është për llogari të detyrimeve të viteve të mëparshme. Nëse në fund të vitit 2014, detyrimet e pashlyera rezultuan në shumën 85,049 mije lekë në fund të vitit 2015 ato u rritën në shumën 91.131 mijë lekë.

Ndër operatorët me detyrimet më të larta renditen shoqëritë UK Tiranë, Durrës, Fier, Kavajë, Krujë, Kurbin, Shkodër Fshat, Tepelenë. Shoqëria UK Tiranë detyrohet për më shumë se 50% të detyrimeve të gjithë shoqërive. Në fund të vitit kjo shoqëri rezulton me detyrime në shumën 48 540 mije lekë.

Pavarësisht këmbënguljes e punës së vazhdueshme të Rregullatorit për vënien në arkëtim të këtyre detyrimeve, rezultatet siç u parashtruan nuk janë të mira.

Mbetet detyrë për Rregullatorin vënia në arkëtim e detyrimeve të prapambetura, përmes bashkëpunimit me shoqëritë dhe me pushtetet vendore.

1.6. Rregullimi për vitin 2016

ERRU gjatë viteve në vazhdim do të vazhdojë të ndërmarrë iniciativa që do të fokusohen në arritjen e objektivave në përmbushje të funksioneve të përcaktuar në ligj duke u fokusuar në:

- ✓ Përmbylljen e procesit të ndryshimeve në ligjin 8102, mbi organizimin dhe funksionimin e Entit Rregullator të Ujit. Këto ndryshime kanë si qëllim kryesor përcaktimin e një pavarësie të qartë institucionale të ERRU-së dhe forcimin e rolit të tij në drejtim të monitorimit të shoqërive UK dhe mbrojtjes së konsumatorit.
- ✓ Miratimin e licencave dhe monitorimin e kushteve të licencimit. Në funksion të reformës territoriale dhe reformës në sektor, lind detyrimisht dhe nevoja e përmirësimit të kuadrit rregullator përkatës përsa i përket ofrimit të një shërbimi UK të licencuar në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- ✓ Analizën e ndryshimeve për tarifë si dhe monitorimin e zbatimit të tyre nga shoqëritë UK. ERRU në funksion të përfshirjes në kuadrin rregullator të zonave ku nuk është ofruar më parë shërbim UK i licencuar, bazuar në analiza tekniko - ekonomike mendon që të aplikojë tarifa tranzite për këto zona, për periudha afatshkurtra deri në krijimin e mundësisë për unifikimin e tarifave brenda zonave të reja të juridiksionit të shoqërive UK.
- ✓ Monitorimin e sektorit në përgjithësi, duke filluar me mbledhjen e të dhënave dhe verifikimin e tyre, inspektime, analiza të detajuara tekniko ekonomike, krahasime bazuar në tregues performance të mirëpërcaktuar, incentiva për shoqëritë UK që performojnë në nivelet e kërkuara, apo penalizime për ato shoqëri që vlerësohen si performues të dobët.
- ✓ Përmirësimin e instrumenteve të tjerë rregullatorë të përdorur, qoftë në mbrojtje të konsumatorit ashtu edhe në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve.
- ✓ Bashkëpunimin me qeverisjen qendrore jo vetëm në kuadër të zhvillimeve si rrjedhojë e reformës territoriale, apo dhe asaj në sektor, po në përgjithësi në lidhje me çdo çështje specifike në sektor.
- ✓ Bashkëpunimin me qeverisjen vendore në lidhje me çështje specifike të sektorit, duke u fokusuar kryesisht në saktësimin e të drejtave dhe detyrave që këto njësi kanë në raport me shërbimin, njohjen me kuadrin ligjor rregullator, funksionin UK, etj.

Duke pasur parasysh këto objektiva, si dhe kufizimet në numër në stafin profesional të ERRU-së, lind nevoja emergjente për të rritur numrin e kapaciteteve teknike dhe përmirësimin e infrastrukturës së ERRU-së.

Në kuadër të reformës së re territoriale dhe ristrukturimit të sektorit, ERRU do të mbështesë zonat e reja administrative të krijuara, në mënyrë që të sigurohet një mbulim total me shërbim ujësjellës e kanalizime i rregulluar, në të gjithë vendin.

2. Gjendja në Sektorin Ujësjellës Kanalizime

2.1. Organizimi i sektorit UK dhe reforma territoriale

Sektorin e shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor. Aktualisht në sektor operojnë 57 operatorë, por ky numër pritet të ndryshojë së shpejti, pas përfundimit të riorganizimit të shërbimit sipas njësive të reja vendore.

Sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, shërbimet ujësjellës e kanalizime janë funksion i njësive vendore (neni 10). Megjithatë nga eksperiencia e viteve të kaluara, shpesh ka rezultuar se njësitë vendore nuk kanë luajtur rolin që ju takon në këtë sektor, duke mos kuptuar drejt përgjegjësitë e tyre në raport me këtë shërbim, edhe pse janë pushteti më afër qytetarit.

Sektorin UK përgjatë kësaj kohe ka vuajtur nga disa fenomene negative si dobësia institucionale, procesi i papërfunduar i decentralizimit, mos koordinimi i investimeve, konfliktet politike në nivel lokal (këshillat bashkiakë), etj. Numri i njësive të qeverisjes vendore ishte relativisht i lartë, dhe kjo ka sjellë luhata dhe pabarazi të larta për sa u përket kapaciteteve lokale për ofrimin e shërbimeve. Fragmentimi i lartë i njësive vendore solli si pasojë edhe fragmentimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve.

Kjo gjendje ka ndikuar direkt në funksionimin jo eficient të organeve të brendshme të shoqërive UK, treguesit e punës, llogaridhënien, etj.

Ashtu siç kemi përmendur edhe në Raportin Vjetor 2014, një hallkë e dobët e mbarëvajtjes së punës së shoqërisë është edhe roli i Kryetarit të njësisë vendore. Të gjitha kompetencat mbi shoqërinë ushtrohen nga këshillat vendore. Ndërkohë, edhe pse Kryetari i NJQV-se zgjidhet direkt nga banorët për të drejtuar punët e njësisë, roli i tij në funksionin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime është i zbehtë. Institucioni i Kryetarit të NJQV deri më sot është në një pozitë periferike për sa i përket menaxhimit të shoqërisë.

Reforma administrative e përfunduar tashmë është një hap tepër i rëndësishëm për sektorin UK. Së bashku me paketën e decentralizimit dhe rishikimit të ligjit për funksionimin dhe organizimin e njësive të qeverisjes vendore, këto akte përbëjnë pikënisjen për reformimin e sektorit UK dhe riorganizimin e shoqërive, sipas hartës së re të organizimit të territorit.

Në stadin aktual, reforma administrative ka reduktuar numrin e njësive vendore bashkëpronare në shoqëri, duke lehtësuar administrimin e shoqërive, si rezultat i përqendrimit të aksioneve në një njësi më të madhe vendore.

Hapi tjetër dhe i domosdoshëm për sektorin është reforma e thellë e mënyrës së organizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur.

Riorganizimi i këtyre shërbimeve sipas kufijve administrativë të njësive vendore, ku në çdo bashki krijohet një shoqëri ujësjellës-kanalizimeve, është i nevojshëm për të realizuar një situatë optimale në garantimin e furnizimit të vijueshëm me ujë të pijshëm dhe në përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të sistemit të kanalizimeve.

Aktualisht është në proces konsultimi drafti i vendimit të Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"

Ky projekt-akt propozon një model të ri dhe sistemon aspektet problematike të organizimit të sektorit, si më poshtë:

- bën përgjegjës direkt njësinë vendore përkatëse duke qartësuar përgjegjësinë në menaxhim;
- qartëson situatën e aseteve të sistemeve ujësjellës-kanalizime, duke detyruar njësitet vendore të kryejnë inventarizimin dhe kontabilizimin e tyre, brenda një kohe të arsyeshme;
- riorganizon shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve (57 të tilla të licensuara dhe 131 ndërmarrje të vogla të njësive vendore të mëparshme në 61 shoqëri, sipas parimit "një bashki, 1 shoqëri UK";
- bashkon të dy shërbimet, si atë të furnizimit me ujë, edhe atë të kanalizimeve nën objektin e veprimtarisë së shoqërive UK, sipas parimit të ekonomisë së shkallës, duke shmangur ndarjen e tyre nga njësitet vendore.

Ndërkohë gjykojmë se është evidente nevoja për hartimin dhe miratimin e një ligji specifik për sektorin ujësjellës-kanalizime. Në rrafshin juridik, sektori UK është organizuar dhe funksionon mbi bazën e disa vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën dhe nuk përcaktojnë shtyllat kryesore të ndërtimit dhe zhvillimit të këtij sektori kaq të rëndësishëm.

Për krijimin e një kuadri të plotë ligjor në sektor i cili do të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë si dhe të institucioneve publike të përfshirë në këtë sektor, modelin e tregut, rregullat e funksionimit të tij, etj, do të ishte i nevojshëm krijimi i një ligji specifik për sektorin.


Të gjithë sektorët e tjerë në Shqipëri, si psh. ai i energjisë, komunikimeve elektronike, shërbimi postar, shërbimi bankar, mbetjeve, etj, kanë një ligj specifik për sektorin, ku pjesë e tij është dhe kuadri rregullator. Ky ligj do të integronte dhe do të harmonizonte të gjitha aktet e shpërndara në kohë dhe do të shmangë paqartësitë, dykuptimësitë dhe interpretimet e ndryshme.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji specifik për sektorin, është edhe objektiv i Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017.

2.2. Mbulimi me shërbim UK dhe sfidat në licencim

Enti Rregullator i Ujit raporton se gjatë vitit 2015, situata në sektor përsa i përket mbulimit me shërbime ujësjellës kanalizime nuk ka patur ndryshime.

Kjo gjendje pritet të ndryshojë me zbatimin e reformës territoriale pasi shoqëritë UK do të duhet të mbulojnë gjithë territorin e vendit me shërbim UK të licencuar. Kjo do të jetë një sfidë për sektorin UK që do të çojë në përmirësimin e shërbimeve për popullsinë, sepse aktualisht popullsia që mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëritë UK është vetëm **81% e popullsisë në zonën e juridiksionit**, ndërsa përsa i përket shërbimit të grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura, ai ofrohet nga shoqëritë UK vetëm për **51% të popullsisë** ku **10 % e popullsisë** merr edhe shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura.




- Zona e juridiksionit e mbuluar me shërbim ujësjellës-kanalizime nga shoqëritë UK
- Zona e juridiksionit e mbuluar vetëm me shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëritë U
- Zona e juridiksionit e shoqërive UK e pambuluar me shërbim nga këto shoqëri
- Zona jashtë juridiksionit të shoqërive UK që mbulohet pjesërisht me shërbim nga vetë bashkitë/komunat

Grafiku 9. Zona e mbulueshmërisë me shërbim nga shoqëritë UK

Pavarësisht se vetëm për 81% të popullsisë në zonën e juridiksionit të shoqërive UK shërbimi ofrohet nga këto shoqëri, ekziston dhe një pjesë tjetër e popullsisë, **rreth 30%** (vetëm 64% e tyre përfitojnë nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe 28% kanë akses në shërbimet e kanalizimeve) jashtë zonave të juridiksionit të tyre, ku shërbimi ofrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësive administrative përkatëse.

Shërbimet UK sigurohen nga 57 operatorë, nga të cilët:

- **5 (pesë)** operatorë kryejnë shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura si dhe shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura;
- **28 (njëzet e tetë)** operatorë ofrojnë të dy shërbimet, atë të furnizimit me ujë dhe grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura;
- **25 (njëzet e pesë)** operatorë ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë, ndërsa shërbimi i largimit të ujërave të ndotura kryhet nga vet njësitë administrative, të cilat kanë filluar të kalojnë këtë shërbim pranë shoqërive UK.



■ Operaret qe ofrojne UK ■ Operaret qe ofrojne UK edhe ITUN ■ Operraret qe ofrojne vetem U

Grafiku 10. Ndarja e operatorëve sipas shërbimeve që ato kryejnë

Në kushtet e miratimit të reformës së re territoriale, shumë njësi administrative do të reduktohen për të krijuar njësi më të mëdha. Kjo reformë lehtëson mjaft çështjen e rregullimit ligjor të zonave të pambuluara, pasi mjaft njësi do të bëhen pjesë e bashkive më të mëdha.

ERRU do të mbështesë njësitë e reja të pushtetit vendor me qëllim që dhe ish komunitat që ishin jashtë juridiksionit të shoqërive ekzistuese UK, të përfshihen në sistemet e tyre të monitorimit dhe të bëhen pjesë e rregullimit.

Nga ana tjetër kjo reformë do të çojë në disa sfida të sektorit ujësjellës kanalizime për t'u realizuar.

Ndër më kryesorët mund të përmendim:

- Grupimi dhe integrimi i shoqërive UK (bazuar në njësitë e reja administrative të krijuara, skemat aktuale të furnizimit me ujë, duke u nisur që nga burimet e deri tek konsumatori final dhe mundësinë e integritit dhe të më shumë se një njësie të re administrative në një shoqëri UK);
- Zonat e shërbimit me qëllim rritjen eventuale të popullsisë së shërbyer;
- Bashkimi i shërbimeve të kanalizimeve me atë të furnizimit me ujë për të gjitha ato raste ku ky shërbim nuk ofrohet fare ose ofrohej nga ish komunat;
- Ndryshim i akteve nënligjore mbi kategoritë e licencimit;
- Mbulimi me shërbim UK të licencuar i gjithë territorit të vendit;

Të gjitha sfidat e mësipërme janë të lidhura ngushtë me procesin e licencimit, i cili është një nga veprimtaritë kryesore për rregullatorin.

Në këtë kuadër dhe Entit Rregullator të Ujit do ti nevojitet të ndryshojë aktet nënligjore në përputhje me formën e organizimit që do të marrin shoqëritë ujësjellës–kanalizime, duke rishikuar gjithashtu rregulloret e licencimit, procedurat e licencimit të kategorive të ndryshme të shërbimit si dhe kushtet e licencimit për çdo operator UK të licencuar.

Gjithashtu, ERRU duhet të licencojë shoqëritë e reja duke përfshirë jo vetëm shërbimin e furnizimit me ujë por dhe atë të largimit të ujërave të ndotura.

Këto shoqëri të reja duhet që të mbulojnë me shërbim UK të licencuar të gjithë territorin duke ofruar standarte shërbimi më të mira për të gjithë konsumatorët por edhe me tarifa të miratuara dhe të përballueshme për të gjithë nivelet e popullsisë.

Përgjegjësia kryesore në këtë situatë mbetet e njësisve administrative, të cilat duhet të ushtrojnë detyrimin ligjor të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, monitorimin e këtij shërbimi si dhe burimet e financimit.



Figura 2. Harta e njësive të reja administrative me zonat nën administrimin e shoqërive U/UK (lista e detajuar e njësive të reja, sipas reformës territoriale, në juridiksionin e shoqërive U/UK dhe zonat e pambuluara me shërbim nga këto shoqëri është paraqitur në Aneksin 4).

2.3. Kostot për shërbimet Ujësjetës e Kanalizime

Treguesit e performancës "Mbulimi i kostos OM" dhe "Mbulimi i Kostos Totale", janë përzgjedhur për të vlerësuar situatën ekonomike të çdo shoqërie dhe sektorit në përgjithësi.

Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes janë kostot që i nevojiten shoqërisë për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Zërat kryesorë të kostove OM janë kostot për personelin, kimikatet, energjinë dhe kosto të tjera që lidhen me operimin e mirëmbajtjen. Këto kosto duhet të jenë të arsyeshme dhe të justifikueshme nga pikëpamja ekonomike.

Treguesi "Mbulimi i Kostove OM" shpreh se deri në çfarë mase kostot e drejtpërdrejta OM (pa amortizimin dhe koston e kredive) mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore .

Në vitin 2015, mbulimi i kostove OM me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti në sektor është 104%. Numri i shoqërive që mbulojnë 100% koston e operimit dhe mirëmbajtjes është 19 (nëntëmbëdhjetë).

ERRU e konsideron mbulimin e kostove OM me të ardhurat nga aktiviteti, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen.


Nga pikëpamja ekonomike, mbulimi i kostove totale (kostot operim dhe mirëmbajtje plus amortizimin dhe koston kapitale) me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera është objektivi kryesor i çdo operatori.

Megjithëse operatorët po punojnë seriozisht për arritjen e këtij objektivi mbetet shumë për të bërë, pasi numri i shoqërive që mbulojnë këto kosto dhe përqindja e mbulimit të kostove totale është ende në nivele jo të kënaqshme.

Për operatorët që kanë mbuluar kostot totale mbi 100%, fitimi do të ndihmojë në grumbullimin e fondeve të nevojshme për shlyerjen e kredive të marra apo realizimin e investimeve me burime të vetë operatorëve.

Në vitin 2015, mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është 79%, dhe vetëm 6 (gjashtë) shoqëri kanë aritur të mbulojnë 100% këto kosto. Bazuar në objektivat e politikës tarifore dhe strategjinë e sektorit, ky objektivi do të arrihet gradualisht, duke filluar së pari me mbulimin e kostove operative dhe mirëmbajtjes (OM).

Niveli i mbulimit të kostove operative dhe mirëmbajtjes dhe tendenca e këtyre treguesve pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm :




Grafiku 11. Mbulimi kostove me të ardhura (në %)

Grafiku i mësipërm tregon se tendenca e këtyre treguesve nuk është pozitive. Krahasuar me një vit më parë nivelet e mbulimit të kostove në sektor janë ulur. Kjo situatë vjen si rezultat i uljes së nivelit të të ardhurave dhe i rritjes së kostove krahasuar me vitin 2014. Kështu, niveli i të ardhurave nga faturimi është ulur me 2% dhe niveli i kostove është rritur me 10%. Mbulimi i kostove është i lidhur me realizimin e të ardhurave dhe kostove të shërbimit. Rritja e të ardhurave dhe ulja e shpenzimeve duhet të jenë në qendër të punës së çdo operatori.

Analiza e detajuar e strukturës së kostos mundëson nga njëra anë vlerësimin e nivelit, domosdoshmërisë dhe leverdisë ekonomike të çdo shpenzimi të kryer, dhe nga ana tjetër gjetjen e mundësive dhe rrugëve për uljen e shpenzimeve.

Shoqëritë që nuk kanë arritur të mbulojnë shpenzimet me të ardhurat duhet të përcaktojnë objektiva të qarta në mënyrë që të arrihet një balancë më e mirë mes kostove dhe të ardhurave. Ekziston hapësira për rritjen e tarifave, por shoqëritë duhet të përmirësojnë efiçencën e tyre operacionale në lidhje me faturimin dhe arkëtimin, kontrollin e kostove, sidomos kostot për stafin dhe energjinë, të cilat përbëjnë edhe pjesën më të madhe të kostove O&M.

Përqindjen më të madhe në totalin e kostove e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqëndrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.



Grafiku 12. Struktura e kostos së shërbimeve UK për vitin 2015.

Kostot për personelin zënë pjesën më të madhe në totalin e shpenzimeve. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, reduktimi i stafit të tepërt dhe rritja e efiçencës në punë mund të përkthehen në kursime të konsiderueshme financiare.

Përgjithësisht operatorët UK kanë **numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje** që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për vitin 2014, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin përlllogaritet 9 punonjës/1000 lidhje. Vetëm për një numër të vogël operatorësh, niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje.

Kostot e energjisë elektrike zënë gjithashtu një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës financiare të operatorëve. Reduktimi i humbjeve, ndërprerja e lidhjeve të paligjshme dhe vendosja e matësve detyrimisht do të sjellë uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë uljen e kostos së energjisë elektrike.

Për operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, dhe sidomos për operatorët që kryejnë edhe shërbimin e trajtimit të ujrave të ndotura efikasiteti i energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë zë të shpenzimeve.

Në totalin e kostove, një pjesë të rëndësishme zënë gjithashtu edhe **shpenzimet për amortizimin**. Investimet e kryera në sektorin UK kanë si burim financimi kryesisht buxhetin e shtetit, donacionet dhe kreditë. Për shoqëritë të cilat burimi i financimit të investimeve janë kreditë, kosto e kredisë është shtesë në koston totale.

Shpenzimet për mirëmbajtjen e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë janë rritur, gjë e cila ka bërë që niveli i këtyre shpenzimeve të zërë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos. Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve vjen si një domosdoshmëri për të bërë të mundur uljen e këtyre kostove.

Nga ana tjetër **rritja e të ardhurave** përmirëson raportin e mbulimit të shpenzimeve. Burimi kryesor i të ardhurave për operatorët për të mbuluar shpenzimet direkte të shërbimeve të ofruara janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët. Në totalin e të ardhurave të ardhurat zënë rreth 95% , subvencionet 4%, dhe të ardhurat financiare 1%.

*Rritja e tarifave ndikon në rritjen e të ardhurave të shoqërive për rrjedhojë edhe mbi mbulimin e kostove O&M, por edhe **menaxhimi efektiv i shërbimeve luan një rol të rëndësishëm**. Faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të paguar për shërbimet e ofruara bëjnë të mundur rritjen e të ardhurave.*

Për të siguruar pavarësinë ekonomike operatorët duhet të realizojnë të ardhurat për përballimin e shpenzimeve. Kjo gjë bëhet edhe më e rëndësishme duke qënë se edhe subvencionet e akorduara nga qeveria për mbulimin e kostove operacionale po vijnë duke u ulur. Edhe gjatë vitit 2015 qeveria ka akorduar subvencione, për mbulimin e kostove operacionale të shoqërive ujësjellës kanalizime, pasi subvencionet për shumë shoqëri, sidomos ato të vogla është i rëndësishëm të për sigurojë vazhdimësinë e aktivitetit.

Pjesa më e madhe e këtyre shoqërive operojnë në zona ku numri i klientëve është ulur për arsye të largimit të banorëve. Kjo situatë bën që nivelet e faturimit të jene të ulta. Nga ana tjetër edhe të ardhurat për familje janë të ulëta dhe rritja e mëtejshme e tarifave me qëllim mbulimin e kostove OM nuk do të ishte e përballueshme nga konsumatorët.

	Madhësia e operatorit (nr i lidhjeve ujësjellës)	% e popullsisë së shërbyer	Mbulimi Kostove O&M	Mbulimi i kostos Totale
Grupi 1	>15.000	76%	115.0%	86%
Grupi 2	3.000 - 15.000	17%	80.0%	63.0%
Grupi 3	<3.000	7%	57.0%	48.0%

Tabela 1. Mbulimi i kostove për tre grupet e operatorëve

Analiza e mbulimit të kostove sipas madhësisë së operatorëve tregon se përgjithësisht janë shoqëritë e mëdha ato që kanë rezultatet më të mira në mbulimin e kostove pasi pjesa më e madhe e operatorëve të vegjël nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë. Për pjesën më të madhe të shoqërive të grupit të dytë është më lehtë të arrihet mbulimi i kostove OM nëpërmjet rritjes së tarifave dhe përmirësimit të treguesve.

ERRU do të stimulojë dhe mbështesë përpjekjet e shoqërive për të përmirësuar shërbimet ndaj klientëve të tyre, por nga ana tjetër kërkon që shoqëritë të marrin në konsideratë të gjitha opsionet për të rritur efikasitetin operacionale.

Në rregullimin e këtij sektori një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu investimet kapitale. Burimi kryesor i financimit të tyre, vazhdojnë të jenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët në formën e huave apo granteve. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si dhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Miratimi i Masterplanit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri është një iniciativë e rëndësishme për sektorin, që mundëson orientimin e investimeve drejt fushave prioritare.

Për Entin Rregullator të Ujit, bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me të gjithë aktorët në sektor është mjaft i rëndësishëm për identifikimin e pengesave dhe mundësive drejt arritjes së vizionit për të patur një sektor ujësjellës kanalizime të pavarur financiarisht i cili ofron shërbime me cilësi më të mirë të mundshme dhe të përballueshme nga të gjithë konsumatorët.

2.4. Performanca e sektorit UK për vitin 2015

Enti Rregullator i Ujit si institucion i pavarur në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, është ligjërisht i mandatuar të paraqesë "gjëndjen në sektor dhe rekomandimet e tij në lidhje me masat që duhet të merren për përmirësimin e këtij sektori". Për këtë arsye ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme performancën e sektorit në tërësi dhe atë të operatorëve që ofrojnë shërbime ujësjellës e kanalizime.

Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Analiza individuale e operatorëve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në sektor pasqyrohet çdo vit në mënyrë të detajuar në "Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime".

Në vitin 2015, nivelet TKP për sektorin si dhe tendenca e tyre në tre vitet e fundit janë:

Nr	Treguesit	Njësia	2013	2014	2015	Tendenca
1	Mbulimi me Ujë	%	80.8	80.8	80.8	=
2	Mbulimi me Kanalizime	%	51	51	51	=
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	113.8	122	104	↘
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	84.6	87	79	↘
5	Norma e Arkëtimit	%	82	91	91	=
6	Niveli i Matjes	%	59	61.2	63	↗
7	Ujë pa të Ardhura	%	67.4	67.2	67	=
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	nr	9.5	8.9	9	=
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	ore/ditë	11.5	12.1	12.1	=

Tabela 6. Treguesit kryesore të performancës^[1]

Nivelet e treguesve kryesorë të performancës tregojnë se në vitin 2015 sektori nuk ka patur ndryshime pozitive të dukshme. Krahasuar me një vit më parë, gjashtë nga këta tregues, mbulimi me ujë, mbulimi me kanalizime, uji pa të ardhura, kohëzgjatja e furnizimit me ujë, efiçenca e stafit dhe norma e arkëtimit nuk kanë ndryshuar.

^[1] TPK për vitin 2015 janë përllogaritur në bazë të të dhënave 9 mujore të marra nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë DPUK.

Niveli i mbulimit të kostove OM dhe Kostove Totale është më i ulët se një vit më parë, pra tendenca nuk ka qenë pozitive. Treguesi i vetëm që ka shënuar rritje është niveli i matjes.

Eksperienca ka treguar se në periudhat zgjedhore, siç ishte edhe viti 2015, ndryshimet në situatën politike ndikojnë edhe menaxhimin e shërbimeve ujësjellës kanalizime. Drejtuesit e shoqërive UK ulin përpjekjet për të mbajtur nën kontroll nivelin e shpenzimeve dhe për të rritur të ardhurat.

Në kuadër të reformës territoriale priten ndryshime edhe në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Ristrukturimi dhe reformimi i këtij sektori në periudhën në vazhdim do të sjellë edhe ndryshimet përkatëse në menaxhimin e tij dhe ofrimin e shërbimit.

Burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK është **arkëtimi i të ardhurave** nga faturimi i shërbimeve të ofruara për konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit.

Në vitin 2015, norma mesatare e arkëtimit në sektor është 91%, në të njëjtin nivel me atë të vitit 2014. Në thelb norma e arkëtimit është një aspekt menaxherial dhe niveli i arritur për këtë tregues shpreh më qartë punën e vetë operatorit. Përgjithësisht shoqëritë edhe gjatë këtij viti kanë treguar vëmendje në drejtim të arkëtimit.

Megjithëse norma e arkëtimit është përmirësuar krahasuar me vitin 2013, për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problem. Rritja e qëndrueshmërisë financiare kërkon që shoqëritë UK t'i japin përparësi faturimit dhe arkëtimit në kohë.

ERRU nxit të gjitha shoqëritë që të ndjekin shembullin e performuesve më të mirë në këtë drejtim në mënyrë që të sigurojnë në të ardhmen qëndrueshmërinë e tyre financiare. Faturimi sistematik i të gjithë klientëve, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu futja në përdorim e arkëtimit të detyruar kontribuojnë në arritjen e një norme më të mirë arkëtimi. Një ndikim pozitiv ka gjithashtu ofrimi cilësor i shërbimeve. Shoqëritë të cilat ofrojnë shërbime cilësore nuk hasin vështirësi në mbledhjen e të ardhurave, edhe kur tarifat janë të larta.

Niveli i matjes është treguesi që merr vlerësim pozitiv. Shoqëritë UK kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive. Niveli mesatar i shërbimit të matur në vitin 2015 është 63%. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi operatorëve të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë.

Megjithëse niveli i shërbimit të matur është rritur, faturimi aforfe vazhdon të jetë në nivel të lartë. Shoqëritë të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit janë të pakta në numër. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur. Për një numër të kufizuar shoqëri shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm.

Për vitin 2015 niveli i shërbimit të matur në sektor ka arritur në rreth 63%. Krahasuar me vitin 2012, niveli i matjes në vitin 2015 është rritur me 7%. Instalimi i matësive është një proces i cili nga viti në vit ka shënuar zhvillime pozitive, megjithatë niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Të dhënat tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësive për të gjithë klientët jo familjarë, proces i cili duhet të ishte përfunduar në fund të vitit 2010.

ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësive plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK. Eliminimi i praktikës aforfe dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësive individual dhe në prodhim duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve. ERRU, mbështet dhe nxit të gjithë operatorët për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësive individual dhe në prodhim.

Kjo praktikë do të ndihmojë gjithashtu edhe në përmirësimin e treguesit “uji pa të ardhura”, i cili në ndryshim nga treguesi i mësipërm mbetet në nivele jo të mira. Pjesa më e madhe e ujit të prodhuar, ose 67% e tij i përket ujit pa të ardhura. Tendenca e këtij treguesi nuk është pozitive. Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve nuk mund të arrihen menjëherë, ka vend për reduktimin e tyre, pasi një pjesë e konsiderueshme i përket humbjeve administrative. Për këtë arsye ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve.

Uji pa të ardhura, është një tregues i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përben shqetësimin kryesor në sektor. Niveli i humbjeve në sektor është 67% e ujit të prodhuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë nuk gjeneron të ardhura.

Eksperienca e shoqërive me performancën më të mirë të këtij treguesi tregon se programet e investimit për zëvendësimin në shkallë të gjerë të infrastrukturës së vjetëruar nuk janë e vetmja pikë nga ku fillon reduktimi i ujit pa të ardhura. Njohja e situatës, vlerësimi i saj, përcaktimi i objektivave strategjike për uljen e humbjeve, janë mundësi që varen nga puna e vetë shoqërive.

Bilanci i Ujit është një instrument i rëndësishëm rregullator i vënë në dispozicion të shoqërive për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura.

Analiza e humbjeve bazuar në Bilancin e Ujit tregon se humbjet menaxheriale janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, pra përveçse një sistemi të amortizuar, niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë.

Reduktimin e ujit pa të ardhura, ERRU e ka parë gjithmonë si një nga treguesit kryesor për të pasur shoqëri të qëndrueshme financiarisht. Për këtë arsye rregullatori nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese afatgjatë mbështet shoqëritë në punën e tyre që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt për këtë sektor.

Në vitin 2015, **efiçenca e stafit** është tregues i cili nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish. Megjithatë ka edhe operatorë ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore.

*Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje **aktualisht është 9**. Krahasuar me vendet e rajonit, niveli i këtij treguesi është i lartë.*

Duke qënë se kostoja e personelit për momentin zë një përqindje të madhe të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes të shoqërive ujësjellës kanalizime, treguesi i efiçencës së stafit është një tregues i vlefshëm për të kuptuar potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se shoqëritë duhet të punojnë për optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar e të motivuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe zgjerimin e bazës së klientëve si disa nga drejtimet për përmirësimin e këtij treguesi.

Nivelet më të larta të efiçencës së stafit janë më të lehta për t'u arritur nga shoqëritë e mëdha, që operojnë në zonat urbane ose me densitet të lartë të popullsisë.

Për sa i përket cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, që matet përmes **vazhdimësisë së shërbimit** dhe **cilësisë së ujit të pijshëm**, performanca e sektorit nuk mund të themi se është ajo e duhura.

*Në vitin 2015 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2014. Konsumatorët janë furnizuar me ujë **mesatarisht 12.1 orë në ditë**. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit.*

Pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur. Operatorët ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 4-24 orë ujë në ditë. Operatorët që ofrojnë furnizim

të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë vetëm Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh. a. UK Pogradec dhe Sh. a. UK Librazhd.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Janë dy parametra kryesorë që vlerësojnë sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm, zbatimi i standardeve bakteriologjike (koliformi) dhe të klorit mbetës.

Për ERRU çdo papajtueshmëri me standartet përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve për shërbimin e ofruar.

Ofruesit e shërbimit, megjithëse mund të jenë duke përmirësuar cilësinë e ujit në pikën e furnizimit, nuk garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët për shumë arsye të tjera si furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët etj.

Përsa i përket cilësisë së ujërave të ndotura, situata nuk ka ndryshuar. Në vend funksionojnë 5 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura të cilat përpunojnë ujërat e ndotura për një numër të kufizuar konsumatorësh. Me vënien në funksionim të impianteve të tjerë situata do të vijë duke u përmirësuar. Rritja e nivelit të trajtimit të ujërave të ndotura do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e jetesës së konsumatorëve.

2.5. Objektivat rregullatore të sektorit UK për vitin 2016

Bazuar në analizën e mësipërme, është tashmë e qartë se nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2015 nuk kanë patur ndryshime pozitive të dukshme. Pavarësisht këtyre rezultateve, nisur edhe nga momenti i reformimit para të cilit ndodhet sektori i UK, ERRU është ambicioze në lidhje me objektivat e sektorit për vitin 2016. Kështu, për nivelin e humbjeve në sektor, objektivi i caktuar është i lartë, por i arritshëm, bazuar në analizën e bilancit të ujit, nga ku rezulton se gjysma e humbjeve vjen si rezultat i humbjeve administrative.

Referencë për caktimin e objektivave të parashikuar prej ERRU për sektorin, është gjithashtu strategjia e qeverisë për sektorin UK 2011 - 2017.

Me miratimin e reformës në sektor, Enti Rregullator i Ujit, në funksion të kësaj reforme, do të ketë parasysh dhe rishikojë jo vetëm mbulueshmërinë me shërbim UK të licencuar të të gjithë territorit të Shqipërisë, por dhe politikën e licencimit apo atë tarifore që duhet të ndjekë.

Nr	Treguesit	Njësia	Realizimi i objektive nga shoqëritë në 2015	Objektivat e ERRU-së për 2016	Objektivat në Strategjinë e Sektorit për 2016
1	Mbulimi me Ujë	%	81	n/a	96/82 ⁵
2	Mbulimi me Kanalizime	%	51	75	87/35 ⁶
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	104	>100	>100
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	79	87	78
5	Norma e Arkëtimit	%	91	95	96
6	Niveli i Matjes	%	63	85	80
7	Ujë pa të Ardhura	%	67	45	45
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	Nr	9	4/6/10	n/a
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	ore/ditë	12.1	18	18
10	Mbulimi me shërbim të trajtuar	%	10	30	35

Tabela 7. Objektivat në lidhje me treguesit e performancës për vitin 2016

Nëpërmjet instrumentave të tij rregullatorë, e kryesisht politikës tarifore, ERRU synon të nxisë operatorët për të realizuar objektivat e mësipërme duke pasur parasysh:

- ✓ Të gjitha shoqëritë, ekzistuese, të bashkuara apo të reja, të hartojnë planet e tyre të biznesit. Në këto plane të përcaktohen synimet afatshkurtër e afatgjatë të menaxhimit të shoqërisë si dhe plani i investimeve e ndërhyrjeve të nevojshme. Kryesisht investimet e ndërhyrjet e shoqërive të orientohen në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës kanalizime. Edhe politika e licencimit e aq më tepër ajo tarifore e ndjekur nga ERRU do të kete në fokus këtë zgjerim, në mënyrë që në të gjithë territorin të ofrohet shërbim i rregulluar e me standarte të njëjta.
- ✓ Uljen e nivelit të ujit pa të ardhura që sipas analizave nga bilanci i ujit rezulton se gati gjysma përfaqëson humbje administrative. Nga ky bilanc vihet re gjithashtu që akoma mungojnë matësat e bilancit dhe komponentët përbërës të tij janë kryesisht të vlerësuar. Operatorët duhet të marrin masa urgjente duke filluar me vendosjen e matësve në prodhim dhe ato të bilancit, fillimisht për të njohur situatën reale të humbjeve. Gjithashtu dhe me evidentimin dhe eliminimin apo legalizimin e lidhjeve të paligjshme, qoftë në transmetim ashtu edhe në shpërndarje.

⁵Mbulueshmëria me ujë në zonën urbane / mbulueshmëria me ujë në zonën rurale

⁶Mbulueshmëria me kanalizime në zonën urbane / mbulueshmëria me kanalizime në zonën rurale

- ✓ Objektivi më i lartë për normën e arkëtimit është parashikuar i tillë, pasi ky tregues është tërësisht i lidhur me menaxhimin e operatorit dhe shpreh qartë punën e vetë shoqërisë.
- ✓ Lehtësimi i procesit të arkëtimit ndihmohet nga rritja e nivelit të matjes së shërbimeve, sidomos për klientët familjarë. Rezultatet tregojnë se faturimi aforfe është akoma në nivel të lartë, ndërkohë që ky proces duhet të ishte mbyllur me kohë. Ende nuk ka përfunduar vendosja e matësave për të gjithë klientët jo familjarë, proces i cili duhet të ishte përfunduar në fund të vitit 2010.
- ✓ Kombinimi dhe realizimi i objektivave të mësipërme, detyrimisht do të çojë në rritjen e vazhdueshmërisë së furnizimit me ujë dhe përmirësimin e cilësisë së ujit.
- ✓ Shoqëritë duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme në analizën për kostot e shërbimeve që kryejnë, sidomos shoqëritë e mëdha e të mesme. ERRU sugjeron analizën mbi qendra kostosh si një nga mënyrat për të evidentuar më lehtë fushat ku duhet të ndërhyet apo metodikat që duhen zgjedhur. Efienca e stafit dhe e energjisë janë dy zërat kryesore në koston e shërbimit e si rrjedhim fokusi i shoqërive duhet të jetë në uljen e këtyre kostove.

Raporti i ERRU-së për performancën e sektorit për vitin 2015, do të synojë një analizë individuale të operatorëve në lidhje me këto objektiva, duke u fokusuar në elementët problematike të tyre dhe sugjeruar zgjidhje të mundshme.

Aneksi 1 – Situata e licencimit të shoqërive UK në vitin 2015

Nr.	Operatorë të pajisur me licencë		Pa licencë
	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi për mbarim afati	
1	Sh.A.U Bulqizë	Sh.A.UK Ballsh (Mallakastër)	Sh.A.U Këlcyrë
2	Sh.A.UK Gjirokastrë	Sh.A.UK Fushë Arrëz	Sh.A.UK Pukë Fshat
3	Sh.A.U Korçë Fshat	Sh.A.U Skrapar	Sh.A.UK Peqin
4	Sh.A.U Oriku	Sh.a.U Has	Sh.A.UK Vlorë
5	Sh.A.UK Elbasan qytet	Sh.A.UK Krastë	
6	Sh.A.UK Sarandë	Sh.A.U Novoselë	
7	Sh.A.UK Fier	Sh.p.k Ujësjetës Vau i Dejës	
8	Sh.A.U Tropojë	Sh.A.U Lushnjë Fshat	
9	Sh.A.UK Himara	Ndërmarrja Ujësjetës Gjirokastrë Fshat	
10	Sh.A.UK Lushnje Qytet	Sh.A.U Bilisht	
11	Sh.A.UK Pogradec		
12	Sh.A.U Selenicë		
13	Sh.A.UK Lezhë		
14	Sh.A.UK Tepelenë		
15	Sh.A.U Peshkopi		
16	Sh.a.UK Krujë		
17	Sh.A.UK Rrogozhinë		
18	Sh.A.UK Korçë qytet		
19	Sh.A.U Përmet		
20	Sh.A.UK Ersekë		
21	Sh.A.UK Libohovë		
22	Sh.A.U Elbasan Fshat		
23	Sh.A.UK Durrës		
24	Sh.a.U Mat (Burrel)		
25	Sh.A.UK Delvinë		
26	Sh.A.U Divjakë		
27	Sh.A.UK Berat - Kuçovë		
28	Sh.A.UK Fushë - Krujë		
29	Sh.A.UK Tiranë		
30	Sh.A.U Kurbin		
31	Sh.A.U Ura Vajgurore		
32	Sh.A.UK Librazhd		
33	Sh.A.UK Rubik		
34	U Komuna Bradashesh		
35	Sh.A.U Patos		
36	Sh.A.U Gramsh		
37	Sh.A.UK Rrëshen (Mirditë)		
38	Sh.A.UK Kavajë		
39	Sh.A.U Poliçan		
40	Sh.A.UK Bashkia Pukë		
41	Sh.A.U Shkodër Fshat		
42	Sh.A.UK Shkodër qytet		
43	Sh.A.U Kukës		

Aneksi 2 - Aplikimet për ndryshimin për tarifa në vitin 2015

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klienteve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit		Tarifat sipas vendimit të KKRR	
			lekë/klientë/muaj	lek/m3	lekë/klientë/muaj	lek/m3	lekë/klientë/muaj	lek/m3
			fikse	variabël	fikse	variabël	fikse	variabël
Sha U Elbasan fshat	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	36	200	84	120	38
		Klientë buxhetor	100	110	200	160	120	120
		Klientë privat	100	110	200	200	120	120
Sha UK Ersekë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	35	100	40	100	38
		Klientë buxhetor	100	90	100	100	100	100
		Klientë privat	100	110	100	120	100	110
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		8		10		10
		Klientë buxhetor		12		12		13
		Klientë privat		18		20		18
Sha UK Sarandë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	120	50		74	150	52
		Klientë buxhetor	120	135		203	150	138
		Klientë privat	120	135		203	150	138
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		18	169	30		20
		Klientë buxhetor		28	169	33		31
		Klientë privat		28	169	33		31
Sha U Korçë Fshat	ujë i pijshëm	Klientë familjarë me matësa		33	100	50	50	38
		Klientë familjarë pa matësa		12.5	500		400	
		Klientë buxhetor		75	100	100	50	90
		Klientë privat		90	100	120	50	95
Sha UK Korçë qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	120	65	120	72	120	65
		Klientë buxhetor	120	110	150	115	120	110
		Klientë privat	120	140	150	140	120	140
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		34		40		34
		Klientë buxhetor		56		67		56
		Klientë privat		56		67		56
Sha U Poliçan	ujë i pijshëm	Klientë familjarë me matësa		37		75		37
		Klientë familjarë pa matësa		166		208		
		Klientë buxhetor		80		133		80
		Klientë privat		95		133		95
Sha UK Durrës	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	58	150	70		në proces
		Klientë buxhetor	100	110	150	120		
		Klientë privat	100	120	150	130		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		35		50		
		Klientë buxhetor		50		60		
		Klientë privat		50		60		
Sha UK Elbasan Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	180	38	180	38		në proces
		Klientë buxhetor	300	115	300	115		
		Klientë privat	500	130	500	130		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		8		8		
		Klientë buxhetor		25		25		
		Klientë privat		30		30		

Aneksi 3 - Tarifat Aktuale për vitin 2015

Lloji i shoqërisë	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të tarifave	Për Ujin e pijshëm lek/m3				Tarife fikse/shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			F	F. aforfe	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha UK	Berat - Kuçovë	01/06/2014	44		125	125	100	200	200	12	20	20
Sha U	Bilisht (Devoll)	01/01/2012	38		100	110	50	50	50			
Sha U	Bulqizë	01/01/2013	17		55	75	100	100	100			
Sha U	Burrel (Mat)	01/01/2006	23		60	80				2	4	6
Sha UK	Delvinë	01/06/2008	48		100	100						
Sha U	Divjakë											
Sha UK	Durrës	01/06/2013	58		110	120	100	100	100	35	50	50
Sha UK	Elbasan (Elber)	01/01/2006	38		115	130				8	25	30
Sha U	Elbasan Fshat	01/06/2015	38		120	120	120	120	120			
Sha U	Ersekë	01/04/2015	38		100	110	100	100	100	10	13	18
Sha UK	Fier	01/05/2014	52		105	125	200	200	200	13	18	20
Sha UK	Fushë Arrez											
Sha UK	Fushë Krujë	01/03/2005	28		60	80				6	10	12
Sha UK	Gjirokastër	01/01/2014	39		112	124	80	80	80	9	14	14
Sha U	Gjirokastër Fshat	01/07/2010	25		60	60						
Sha U	Gramsh	01/01/2011	32		90	90						
Sha U	Has	01/03/2002	25		60	80						
Sha UK	Himarë											
Sha UK	Kavajë	01/07/2010	38		80	100	100	100	100	15	20	20
Sha U	Këlcyrë	01/01/2012										
Sha UK	Korçë	01/01/2014	65		110	140	120	120	120	34	56	56
Sha U	Korçë Fshat	01/07/2015	38	400	90	95	50	50	50			
Sha U	Krastë	01/07/2007	30		80	100				7	10	15
Sha UK	Krujë	01/06/2007	33		80	80				8	12	12
Sha U	Kukës	01/10/2004	25		60	80				7	15	20
Sha U	Kurbini	01/01/2011	30		80	120	50	50	50			
Sha UK	Lezhë	01/01/2014	58		135	145	200	200	200	18	22	27
	Libohovë											
Sha UK	Librazhd	01/03/2012	38		100	100				13	22	23
Sha UK	Lushnjë	01/04/2014	54		125	135	100	200	200	15	20	22
Sha U	Lushnjë Fshat	01/01/2006	60		70	100						
	Mallakastër											
Sha UK	Mirditë	01/01/2012	30		100	115				10	15	15
Sha U	Novoselë	01/01/2012	33		50	70						
Sha U	Orikum	01/01/2011	25		70	75	100	100	100			

Lloji i shoqërisë	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të tarifave	Për Ujin e pijshëm lek/m3				Tarife fikse/shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			F	F. aforfe	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha U	Patos											
Sha UK	Peqin	01/07/2010	30		90	100	50	50	50			
Sha U	Përmet	01/01/2013	40		110	120	100	100	200			
Sha U	Peshkopi	1/1/2010 dhe	27		65	85				10	15	18
Sha UK	Pogradec	01/01/2013	22/62		37/111	37/111	200+10	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
Sha U	Poliçan	01/07/2010	37		80	95						
Sha UK	Pukë	01/01/2014	35		130	140	100	100	100	8	16	16
Sha UK	Pukë Fshat											
Sha UK	Rrogozhinë	01/01/2013	48		90	100	50	100	100	10	12	12
Sha UK	Rubik	01/10/2008	30		70	100				7	10	15
Sha UK	Sarandë	01/05/2015	52		138	138	150	150	150	20	31	31
Sha U	Selenicë	01/07/2010	30		80	100						
Sha UK	Shkodër	01/01/2012	40		110	110	100	100	100	15	20	20
Sha U	Shkodër Fshat	01/01/2012	50		120	120						
Sha U	Skrapar	01/03/2010	27		80	95						
Sha U	Tepelenë	01/01/2014	33		100	120	90	400	250	12	20	20
Sha UK	Tiranë	01/01/2012	45		120	135	100	100	100	11	30	35
Sha U	Tropojë	01/11/2004	19		60	80						
Sha U	Ura Vajgurore	10/01/2007	40		90	100						
Shpk	Vau i Dejës											
Sha U	Vlorë	01/05/2013	30		60	80	80	80	80	11	13	13

Aneksi 4 - Zonat e juridiksionit sipas Reformës territoriale për shoqëritë UK ekzistuese dhe zonat e pambuluara me shërbim nga këto shoqëriⁱ.

Bashkia	Njësitë administrative përbërëse ⁱⁱ	Shoqëritë U-K ekzistuese	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Berat 1	Berat	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Qyteti Berat
	Velabisht		Fshatrat; Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Velabisht, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnje, Duhanas, Kodras
	Otlak	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Fshatrat; Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e Sipërme, Orizaj, Otlak
	Sinjë		Fshatrat; Sinjë, Mbolan, Mbjeshevë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmënzëzë 1, Osmënzëzë 2, Plashnik i Vogël, Molisht
	Roshnik		Fshatrat; Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimas, Perisnak, Qafë Dardhë, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël, Vojnik, Rabjak
Ura Vajgurore 2	Ura- Vajgurore	Sh.a.U-K Ura Vajgurore	Qyteti Ura Vajgurore, Fshatrat; Bistrovicë, Konisbaltë, Pashalli, Vokopolë, Skrevan
	Poshnje	Sh.a.UK Ura Vajgurore dhe sh.a.Ujesj Lushnje (F)	Fshatrat; Poshnje, Polizhan, Çiflik, Arrëz, Agim, Banaj, Gajdë, Malas Gropë, Syzez, Sheq Gajdë, Hingë, Kuç
	Kutalli		Fshatrat; Kutalli, Sqepur, Drenovicë, Samaticë, Pobrat, Rërëz, Protoduar, Goriçan Qendër, Goriçan Çlirim, Malas Breg
	Cukalat		Fshatrat; Donofrosë, Slanicë, Cukalat, Allambres, Krotinë, Çetë
Kuçovë 3	Kuçovë	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Qyteti Kuçovë
	Kozare	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Fshatrat; Havalehas, Kozare, Feras Kozare, Salcë Kozare, Vlashuk, Demollarë, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë, Frashër
	Perondi	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Fshatrat; Perondi, Magjatë, Tapi, Goraj, Velagosht, Rreth Tapi, Polovinë
	Lumas		Fshatrat; Lumas, Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrak, Sheqës, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz, Koritëz
Skrapar 4	Çorovodë	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Qyteti Çorovodë
	Qëndër Skrapar	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Fshatrat; Zogas, Kalanjas, Dhores, Veseshë, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzhezhë, Slatinjë, Storrë
	Bogovë	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë dhe Sh.a.Ujësjiellës Polican	Fshatrat; Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan
	Vëndreshë	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë dhe Sh.a.Ujësjiellës Polican	Fshatrat; Lavdar, Spatharë, Therapel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro
	Çepan	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Fshatrat; Çepan, Muzhakë, Rog, Zabëzhan i Ri, Zabëzhan, Blezëncë, Malind, Muzhëncë, Sevran i madh, Sevran i Vogël, Qeshibes, Strënc, Kakos, Prishtë
	Potom	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Fshatrat; Potom, Gjergjovë, Koprëncë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrmiş, Staraveckë
	Leshnje		Fshatrat; Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Faqekuq, Gostëncë, Leshnje, Vlushë, Bërsakë
	Gjerbës	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Fshatrat; Mëlovë, Zaloshnjë, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Strafcikë, Vishanj, Barçi 1, Barçi 2, Kuç, Rehovë, Grëms, Gjogovicë, Floq
	Zhepë	Sh.a.Ujësjiellës Çorovodë	Fshatrat; Grevë, Posten, Kovaçanj, Gurazez, Çorrotat, Cericë, Zhepë, Leskovë, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërrovë, Dobrenj, Buranj, Luadh, Shpatanj

Poliçan 5	Poliçan	Sh.a.Ujësjiellës Polican	Qyteti Poliçan
	Tërpan		Fshatrat; Tërpan, Teman, Paraspuar, Tozhar, Vokopolë, Dodovec, Rehovë, Zhapokikë, Çorogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom i Vogël
	Vërtop	Sh.a.UK Berat Kucove	Fshatrat; Mbrakull, Vërtop, Kapinovë, Zgërbonjë, Vodicë, Fushë Peshtan, Peshtan, Drenovë, Lybeshë, Tomor i Madh, Tomor i Vogël, Bregas
Dibër 6	Peshkopi	Sh.a.UK Peshkopi	Qyteti Peshkopi
	Tomin	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan
	Melan		Fshatrat; Melan, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Begjuncë, Trepçë, Grevë, Illicë, Bellovë, Pejkë, Pjeçë, Trenë
	Kastriot	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje
	Lurë		Fshatrat; Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmollë, Krej-Lurë, Pregj-Lurë, Sumej, Vlashej
	Maqellarë		Fshatrat; Maqellarë, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovolani, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinat, Gradec
	Muhurr		Fshatrat; Muhurr, Bulaç, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej
	Luzni	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Katund i Ri, Hoteshe, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm
	Selishtë		Fshatrat; Selishtë, Kacni, Lukan, Murrë, Qafë-Murrë, Selishtë e Sipërme
	Sillovë	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Sillovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak
	Kala e Dodës	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie
	Zall-Dardhë		Fshatrat; Zall-Dardhë, Lashkizë, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënllëshën, Tartaj
	Zall-Reç		Fshatrat; Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draj-Reç, Gur-Reç, Hurdhë-Reç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë
	Fushë Çidhën	Sh.a.UK Peshkopi	Fshatrat; Fushë Çidhën, Blliçe, Laçe, Rrenz
Arras		Fshatrat; Arras, Gur i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë	
